

# EPOKA ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5637  
E shtunë, 24 nëntor 2018  
çmimi 0.40 €

Vitin tjetër do të  
blihen edhe 1 300  
shtretër për QKUK-në

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)




facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## AKTUALE

**TEKTONIKAT  
GJEOPOLITIKE  
DHE  
DIPLOMATIKE  
NË BALLKAN  
DHE KOSOVA** F. 8



Prof. Lisen BASHKURTI

**BE, PRESIONIN  
DREJTOJE NDAJ  
ATYRE QË KANË  
BËRË LUFTËRA E  
GJENOCIDE NË  
HAPËSIRAT E  
ISH-JUGOSLLAVISË** F. 12



Nga Jakup KRASNIQI

**ARRESTOHEN TRE PERSONA  
TË DYSHUAR PËR VRASJEN E  
OLIVER IVANOVIQIT** F. 7

## EKONOMI

**QEVERIA KËRKON TË  
NDËRPRITEN REDUKTIMET  
E ENERGJISË** F. 9

**MINISTRI SHALA  
NËNSHKRUAN DEKLARATËN  
PËR BASHKËPUNIM ME  
VENDET E EFTA-s** F. 9

## KULTURË

**NJË  
PËRVJETOR MES  
PËRVJETORËSH** F. 12

Prof. dr. Hysen  
MATOSHI



## SPORT

**FERONIKELI ME FITORE  
NDAJ DRITËS SYNON  
TË BËHET LIDER** F. 18



FLET PËR "EPOKËN E RE" POLITOLOGU  
BARDHYL MAHMUTI | FAQE 4-5

## Me blerjen e produkteve serbe e forcojmë Serbinë për të na luftuar

Politologu Bardhyl Mahmuti ka komentuar vendimin e Qeverisë së Kosovës për vendosjen e taksës doganore 100 për qind për produktet e Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ky vendim

është i peshuar mirë. Bardhyl Mahmuti ka bërë me dije se Serbia ka përfutur mbi pesë miliardë euro nga tregu i Kosovës. "Të gjithë duhet të jemi të vetëdijshëm se këto miliarda euro të Kosovës shfrytëzohen edhe për armatosjen e Serbisë me armët më të

sofistikuara ruse, shfrytëzohen edhe për mobilizimin diplomatik që të tërhiqen njohjet nga shtetet që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, shfrytëzohen edhe për pengimin e anëtarësimit në institucione dhe organizata ndërkombëtare", ka thënë Bardhyl Mahmuti

**FSK-ja dhe  
policia,  
institucionet më  
të besueshme  
në Kosovë** | FAQE 6



## Veseli: Nuk do ta lejojmë cenimin e Kosovës nga Serbia

Kryeparlamentari Kadri Veseli ka vlerësuar se vendimet e fundit të shtetit të Kosovës kanë për synim ta ndalin destruktivitetin e liderëve institucionalë të Serbisë. Në një konferencë me gazetarë, ai ka thënë të premten se nuk do të lejohej cenimi i sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës. Sipas Veselit, Serbia dhe lidhshipi i saj duhet ta kuptojnë se politika e urrejtjes, e bllokimit dhe e provokimit ndaj



Kosovës është duke rrezikuar stabilitetin rajonal | FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji  
BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Hahn flet me Thaçin, Haradinajn e Vuçiqin

**BRUKSEL, 23 NËNTOR** - Komisionari evropian i Zgjerimit, Johannes Hahn, ka folur në një bisedë telefonike me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, kryeministrin Haradinaj si dhe presidentin e Serbisë, Aleksander Vuçiq, pas zhvillimeve të së premtes në veri të vendit. Hahn përmes një postimi në "Twitter" ka thënë

se pas bisedave me ta është pajtuar që të gjendet një situatë për parandalimin e eskalimit të situatës.

Gjithashtu, Hahn është shprehur se liderëve të Kosovës dhe Serbisë u ka ofruar ndihmë për kapërcimin e situatës pas vendosjes së taksës prej 100 përqindësh ndaj produkteve me prejardhje nga Serbia dhe

Bosnja. "Sapo bisedova me presidentin Vuçiq, presidentin Thaçi dhe kryeministrin Haradinaj. U pajtuam për parandalimin e eskalimit të situatës, në interes të të gjithë rajonit. Po ashtu, u ofrova ndihmë për gjetjen e një zgjidhjeje praktike në masën e importit", ka shkruar Hahn në "Twitter".



## Maqedonia, përfituese nga beteja tregtare Kosovë - Serbi

Pas vendimit të Qeverisë së Kosovës që ta rrisë 100 për qind taksën doganore për produktet e importuara nga Serbia dhe Bosnja, tregtarët nga Maqedonia janë ata që mund të kenë më së shumti përfitim nga "lufta" ekonomike ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit

**SHKUP, 23 NËNTOR** - Tregtarët nga Maqedonia janë ata që mund të kenë më së shumti përfitim nga "lufta" ekonomike ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, pas vendimit të Qeverisë së Kosovës që ta rrisë 100 për qind taksën doganore për produktet e importuara nga Serbia dhe Bosnja. Drilon Iseni, drejtor i Odës Ekonomike të Maqedonisë

Veri-Perëndimore, konsideron se Maqedonia, për shkak të situatës së re të krijuar në Kosovë me produktet serbe, duhet t'i dalë në ndihmë tregut të Kosovës për nevojat reale që ka rreth produkteve të ndryshme. Në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë", Iseni thotë se kjo paraqet edhe një mundësi të mirë për tregtarët e Maqedonisë për të realizuar



përfitime. "Ky rast duhet shfrytëzuar një herë për ta ndihmuar tregun e Kosovës me produktet që ekzistojnë në Maqedoni, e dyta duhet përfituar nga ky rast që t'i jepet një stimul i ri këmbimit

tregtar mes Maqedonisë dhe Kosovës. Ky është një përfitim afatshkurtër që mund ta ketë ekonomia vendore e Maqedonisë, ndonëse ne mendojmë se kjo çështje duhet të shihet në perspektivë më afatgjatë, duke krijuar kushte që kjo tregti të avancohet edhe më shumë, para së gjithash, me avancimin e projekteve infrastrukturore këtu në Maqedoni", thotë Iseni, duke shtuar se Kosova mbetet një nga partneret më të rëndësishëm të Maqedonisë. Njohësit e çështjeve ekonomike thonë se Qeveria e Maqedonisë në këtë situatë duhet të bëjë një analizë të thuktë se çfarë i nevojitet më së shumti tregut të Kosovës, që të krijohet një pasqyrë e qartë rreth asaj se ku duhet të fokusohen tregtarët nga Maqedonia.

Ndërkohë, nga Ministria e Ekonomisë së Maqedonisë thonë se "përfitimet e Maqedonisë nga vendimi i Kosovës për rritjen e doganave me Serbinë mund të jenë afatshkurtra". Ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi, thekson se Maqedonia nuk do të përzihet në këtë kontest, duke i lënë palët që vetë ta zgjidhin problemin. "Ne konkurrën e bazojmë në fuqinë e kompanive, por edhe të prodhimeve tona se sa mund të jenë konkurruese, e jo nga kjo masë që mund të sjellë përfitime, por ato përfitime janë afatshkurtra", thotë Bekteshi.

Edhe nga Ministria e Bujqësisë e Maqedonisë theksojnë se Maqedonia si vend anëtar i CEFTA-s nuk duhet ta synojë përfitimin e tregjeve përmes barrierave apo kontesteve që kanë shtetet mes tyre. Në këtë drejtim, Veljo Tantarov, kryetar i Lidhjes së Prodhimeve Bujqësore, thotë se Serbia në Kosovë më së shumti importon miell dhe prodhime nga drithërat - prodhime këto që janë të mangëta në Maqedoni, sepse edhe ajo i merr nga Serbia. Ai shton se në këtë drejtim mund të ndodhë riimportimi i mallrave nga Serbia përmes Maqedonisë dhe ato sërish të shkojnë në Kosovë.

## Kocijançiq: Kosova ta respektojë sundimin e ligjit

**BRUKSEL, 23 NËNTOR** - Zëdhënësja e Bashkimit Evropian, Maja Kocijançiq, konfirmoi se institucionet e BE-së me kujdes po përcjellin ngjarjet e së premtes në Kosovë, dhe se po mbajnë kontakte të vazhdueshme me palë të ndryshme. Ajo u bëri thirrje institucioneve të Kosovës që "t'i përmbahen plotësisht sundimit të ligjit". "Ne presim që autoritetet



përgjegjëse në Kosovë të bëjnë gjithçka që është nën

pushtetin e tyre, për t'i sjellë autorët e këtij krimi para drejtësisë, pa vonesë", tha Kocijançiq.

Policia e Kosovës ka arrestuar të premten katër persona në veri të Mitrovicës, tre prej të cilëve janë të dyshuar në lidhje me vrasjen e politikanit serb nga kjo pjesë e Kosovës, Oliver Ivanoviq. Veprimi ngjalli reagime të shumta te serbët lokalë dhe Beogradi zyrtar.

## Basha: Po protestojnë hallexhinjtë, jo opozita

**TIRANË, 23 NËNTOR** - Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ishte i pranishëm sërish në protestën e banorëve të Astirit.

"Edi Rama është një hajdut, sepse do të vjedhë 40 milionë euro, duke shkelur ligjin, duke shkelur Ligjin e prokurimeve, duke shkelur Ligjin e legalizimeve, duke shkelur

Kushtetutën, duke shkelur ligjet për shpronësimet. Ky nuk është projekt për qytetin e Tiranës, ky është projekt për Vilën e Surrelit. Agai i Surrelit do që me një të rënë të lapsit, të marrë 40 milionë euro, pasi pazaret i ka bërë kokë për kokë, është ulur ai kokë më kokë për t'i bërë pazaret e tenderit, për të vjedhur 40 milionë euro. Ndërsa ne jemi këtu

në krah të këtyre njerëzve për t'i mbështetur dhe për të denoncuar këtë megavjedhje", deklaroi Basha.

"Qytetarët nuk duhet të presin që kjo e keqe të vijë në dyert e tyre, por duhet të bashkohen këtu, sepse kjo betejë nuk është vetëm për këta protestues dhe familjet e tyre, por është për të gjithë qytetarët. Shikoni, ato 40

milionë euro që do të marrë agai i Surrelit, se ky është projekt i Vilës së Surrelit, nuk është projekt i qytetit të Tiranës. Kjo është megavjedhje. Nuk ka në analet e historisë së infrastrukturës botërore, ky është kandidat për librin Guinness për vjedhjen që po bëhet këtu, dhe kjo vjedhje bëhet drejtpërdrejt nga Edi Rama. Pse nuk është bërë



prokurimi? Sepse ky vetë është ulur kokë më kokë me ato tri kompanitë dhe u ka thënë: ti do marrësh qaq e unë qaq", tha Basha.

## Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka mbajtur konferencë për medie

# Veseli: Nuk do ta lejojmë cenimin e Kosovës nga Serbia

Kryeparlamentari Kadri Veseli ka vlerësuar se vendimet e fundit të shtetit të Kosovës kanë për synim ta ndalin destruktivitetin e liderëve institucionalë të Serbisë. Në një konferencë me gazetarë, ai ka thënë të premten se nuk do të lejohet cenimi i sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës. Sipas Veselit, Serbia dhe lidhshipi i saj duhet ta kuptojnë se politika e urrejtjes, e bllokimit dhe e provokimit ndaj Kosovës është duke rrezikuar stabilitetin rajonal

**EPOKA  
ERE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Vendimet e fundit të shtetit të Kosovës kanë për synim ta ndalin destruktivitetin e liderëve institucionalë të Serbisë kundër Kosovës. Kështu ka deklaruar të premten kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në një konferencë me gazetarë. Ai ka thënë se vendimet e shtetit të Kosovës janë legjitime, legale dhe transparente. Sipas Veselit, këto vendime nuk duhet assesi të interpretohen si vendime të drejtuara ndaj një komuniteti të caktuar. "Republika e Serbisë, lidhshipi i saj, duhet ta kuptojë se politika e urrejtjes, e bllokimit dhe e provokimit ndaj Kosovës është duke rrezikuar stabilitetin rajonal. Është kundër frymës së dialogut të proklamuar. Kjo politikë nuk i ndihmon bashkëjetesës mes shqiptarëve, serbëve dhe komuniteteve të tjera në Kosovë. Ka ardhur koha që të ndalen provokime të tilla", është shprehur Veseli.

Kryeparlamentari Veseli ka bërë me dije se nuk do të lejohen veprimet që mund të shkaktojnë pasiguri ose jostabilitet në vendin tonë. "Nuk do ta lejojmë cenimin e sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës. Nuk do të lejojmë veprime që kërcënojnë shqiptarët, serbët dhe komunitetet e tjera në veri të vendit.

Nuk do të lejojmë veprime që cenojnë bashkëqytetarët tanë serbë kudo që jetojnë në Kosovë", ka theksuar Veseli. Ai u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve që të kenë besim në institucionet e Kosovës dhe të mos bien pre e provokimeve dhe gjuhës së urrejtjes. "Kosova është e angazhuar t'i zgjidhë problemet me Serbinë në mënyrë konstruktive, përmes dialogut dhe mirëkuptimit. Por, kjo nuk do të thotë se ne do t'i tolerojmë pafundësisht synimet destruktive ndaj shtetit tonë apo përpjekjet për ta tensionuar çdoherë gjendjen në Kosovë. E ardhmja e Kosovës dhe e gjithë rajonit është integrimi në Bashkimin Evropian. Republika e Kosovës është e angazhuar që të garantojë stabilitet, sundim të ligjit në çdo pjesë të territorit të vet. Shteti i Kosovës do t'i respektojë plotësisht obligimet ndërkombëtare që ka marrë. Gjithashtu, institucionet e Kosovës do të funksionojnë dhe vepronë në përputhje të plotë me Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet në fuqi", ka deklaruar Veseli.

**Haradinaj, ambasadorëve të Quintit: Kosova ishte e detyruar ta vendosë taksën ndaj Serbisë**

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, të premten ka pritur në takim të ngarkuarën me punë

në Misionin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Kosovës, ambasadorët e Britanisë së Madhe, Gjermanisë, Francës, Italisë dhe përfaqësuesin e Zyrës së BE-së në Kosovë, me të cilët ka biseduar për zhvillimet e fundit politike në vend. Gjatë takimit, kryeministri Haradinaj i ka njoftuar ambasadorët e Quintit rreth zhvillimeve të fundit politike dhe për vendimin e Qeverisë së Kosovës për vendosjen e masës prej 100 % për produktet me origjinë nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, duke thënë se Qeveria e Kosovës ka qenë e detyruar të ndërmarrë këtë

veprim pas pengesave të vazhdueshme që Serbia po ia bën Kosovës. Ai i ka siguruar ambasadorët e Quintit se situata politike dhe e sigurisë në Kosovë është e qetë dhe Qeveria e Kosovës është e përkushtuar ta ruajë rendin dhe qetësinë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, duke demantuar dezinformatat për të ashtuquajturën krizë humanitare në veri të vendit.

Haradinaj ka theksuar se qytetarëve të vendit, pa dallim vendi apo përkatësi etnike, nuk do t'u mungojë asnjë produkt bazik ushqimor dhe mjekësor dhe se deklaratat e politikanëve serbë janë veçse një veprim tjetër pro-

pagandues, i pavërtetë dhe i papranueshëm për realitetin në vend. Kryeministri Haradinaj ka bërë me dije se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar të sigurojë paqe dhe stabilitet për të gjithë qytetarët e republikës. Haradinaj ka falënderuar ambasadorët e Quintit për përkrahjen e vazhdueshme dhe të gjithanshme për Kosovën në të gjitha proceset, duke i ftuar të jenë objektivë sa i përket vlerësimit të situatës në vend.

Kryeministri Haradinaj ka rithesuar se vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës do të mbetet në fuqi deri në realizimin e objektivave të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

## Ministri Bytyqi premtion përkrahje për fëmijët me nevoja të veçanta



PRISHTINË, 23 NËNTOR (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka pritur të premten në takim përfaqësuesit e shoqatave të personave me nevoja të veçanta, me të cilët ka biseduar rreth përmirësimit të cilësisë së arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta në Republikën e Kosovës.

Në këtë takim, përfaqësuesit e shoqatave të personave me nevoja të veçanta e informuan ministrin Bytyqi për gjendjen aktuale në institucionet apo shoqatat që ata përfaqësojnë dhe

që merren me personat me nevoja të veçanta, për vështirësitë e problemet që ata kanë në jetën e përditshme.

Ministri Bytyqi ka theksuar gatishmërinë e plotë të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, për ta bërë maksimumin për kushte sa më të mira për fëmijët me nevoja të veçanta dhe u shpreh i gatshëm të bashkëpunojë me shoqatat dhe qendrat burimore, që të ofrojnë mbështetje për çdo nevojë që kanë brenda mundësive si ministri. Ministri Bytyqi shtoi se me

angazhimin e 100 asistentëve të rregullt, sipas kërkesave të komunave, si dhe iniciativave për angazhimin e studentëve vullnetarë për të punuar me fëmijët me nevoja të veçanta, tregon synimin e tyre që të bëjnë më të mirën e mundshme për këtë kategori të shoqërisë.

Bytyqi ka theksuar edhe nevojën e vazhdimit të bashkëpunimit me donatorët, të cilët vazhdojnë të shprehin interesim që ta mbështesin arsimimin dhe përmirësimin e kushteve të personave me nevoja të veçanta.

Flet për "Epokën e re" politologu Bardhyl Mahmuti

# Me blerjen e produkteve serbe e f

## "Epoka e re"

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Politologu shqiptar Bardhyl Mahmuti, në këtë intervistë për "Epokën e re", duke komentuar vendimin e Qeverisë së Kosovës për vendosjen e taksës doganore 100 për qind për produktet e Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës, ka thënë se Serbia ka përfituar mbi pesë miliardë euro nga tregu i Kosovës. "Të gjithë duhet të jemi të vetëdijshëm se këto miliarda euro të Kosovës shfrytëzohen edhe për armatosjen e Serbisë me armët më të sofistikuara ruse, shfrytëzohen edhe për mobilizimin diplomatik që të tërhiqen njohjet nga shtetet që kanë njohur pavarësinë e Kosovës, shfrytëzohen edhe për pengimin e anëtarësimit në institucione dhe organizata ndërkombëtare, shfrytëzohen edhe për pagesat e strukturave të pushtetit serb në Kosovë. Me një fjalë, çdokush që blenë produkte serbe kontribuon me paratë e veta të forcohet Serbia që të na luftojë edhe më fuqishëm", ka thënë Bardhyl Mahmuti.

Politologu i njohur shqiptar ka propozuar që taksat prej 100 për qind për produktet serbe të shkojnë në një fond të veçantë për dëmshpërblimin e viktimave të gjenocidit serb. Duke komentuar reagimin e zonjës Federica Mogherini, e cila në emër të BE-së kërkoi që taksat të hiqeshin menjëherë, Bardhyl Mahmuti ka thënë se pa marrë parasysh se nga kush dhe të cilës natyrë do të jenë presionet ndaj institucioneve të shtetit të Kosovës, një gjë është e sigurt: "Nuk ka asnjë forcë dhe asnjë presion që detyron



**Politologu Bardhyl Mahmuti ka komentuar vendimin e Qeverisë së Kosovës për vendosjen e taksës doganore 100 për qind për produktet e Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ky vendim është i peshuar mirë. Bardhyl Mahmuti ka bërë me dije se Serbia ka përfituar mbi pesë miliardë euro nga tregu i Kosovës. "Të gjithë duhet të jemi të vetëdijshëm se këto miliarda euro të Kosovës shfrytëzohen edhe për armatosjen e Serbisë me armët më të sofistikuara ruse, shfrytëzohen edhe për mobilizimin diplomatik që të tërhiqen njohjet nga shtetet që kanë njohur pavarësinë e Kosovës, shfrytëzohen edhe për pengimin e anëtarësimit në institucione dhe organizata ndërkombëtare", ka thënë Bardhyl Mahmuti**

qytetarin e Kosovës të blejë produkte serbe!".

**Serbia ka përfituar mbi pesë miliardë euro nga tregu i Kosovës**

"Epoka e re": Qeveria e Kosovës ngriti taksat për produktet e ndërmarrjeve të Serbisë dhe të Bosnjës e Hercegovinës në masën 100 për qind. Shumica e interpretimeve këtë vendim e ndërlidhin me dështimin e Kosovës që të anëtarësohet në Interpol. Çfarë mendoni ju?

Mahmuti: Meqenëse vendimi i Qeverisë së Kosovës pasoi dështimin diplomatik në Dubai, shumëkush e sheh këtë vendimin të lidhur me zhvillimet rreth përpjekjeve të Kosovës për t'u anëtarësuar në institucione dhe në organizata ndërkombëtare. Mendoj se

gjërat duhet të shihen të ndara. Edhe sikur të mos kishim pengesat për t'u anëtarësuar në Interpol, një taksë e veçantë për produktet e shtetit që ka ushtruar gjenocid në Kosovë del si domosdoshmëri. Kjo taksë duhet të shkojë në fond të veçantë për dëmshpërblimin e viktimave të gjenocidit serb. Përveç vendimeve qeveritare, në raportet tregtare me Serbinë përgjegjësi vendimtare kanë të gjithë qytetarët e Kosovës. Vetëm gjatë dhjetë vjetëve nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, Serbia ka përfituar mbi pesë miliardë euro nga tregu i Kosovës. Të gjithë duhet të jemi të vetëdijshëm se këto miliarda euro të Kosovës shfrytëzohen edhe për armatosjen e Serbisë me armët më të sofistikuara ruse, shfrytëzohen edhe për mobilizimin diplo-

matik që të tërhiqen njohjet nga shtetet që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, shfrytëzohen edhe për pengimin e anëtarësimit në institucione dhe organizata ndërkombëtare, shfrytëzohen edhe për pagesat e strukturave të pushtetit serb në Kosovë. Me një fjalë, çdokush që blen produkte serbe kontribuon me paratë e veta të forcohet Serbia që të na luftojë edhe më fuqishëm.

**Iniciativat për bojkotin e produkteve serbe kanë qenë të pranishme edhe para edhe pas luftës çlirimtare të Kosovës**

"Epoka e re": Sipas jush, krahas masave shtetërore në raport me produktet serbe, a duhet që edhe qytetarët e Kosovës të jenë

# orcojmë Serbinë për të na luftuar

në strumbullar të mobilizimeve për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave tona kombëtare, më 27 shkurt 1989, në Pallatin "Cankariev Dom" të Lublanës, mbi 400 mijë sllovenë nënshkruan peticionin në mbrojtje të Kosovës. Ky solidaritet i paparë deri në atë kohë e tërboi regjimin e Beogradit. Të gjitha institucionet republikane dhe partiake të Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi, sollën vendim që të bojkotohen mallrat e Sllovenisë. Në këtë kontekst historik, Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK), e vetmja organizatë atdhetare shqiptare e asaj kohe që vepronte në klandestinitet, lëshoi komunikatë përmes së cilës kërkonte nga të gjithë shqiptarët që t'i bojkotonin mallrat e Serbisë, Maqedonisë dhe të Malit të Zi. Fatkeqësisht, edhe në atë periudhë, edhe pas gjenocidit serb në Kosovë, ky aspekt i luftës nuk ka pasur shtrirjen e duhur.

**"Epoka e re":** Sipas jush, çfarë efekti do të duhej të kishte qëndrimi refuzues i qytetarëve të Kosovës ndaj produkteve serbe?

**Bardhyl Mahmuti:** Po sjellë shembull takimin me një numër senatorësh belgë që ishin për vizitë në Kosovë në vitin 1999. Në atë kohë ishte aktualizuar kërkesa për bojkotimin e produkteve të Serbisë dhe kërkuan nga unë qëndrimin e Qeverisë së Përkohshme, ministër i Punëve të Jashtme të së cilës isha. Në atë kohë shpreha skepticizmin tim për realizimin e një gjëje të tillë, sepse çdo gjë ishte nën kontrollin e UNMIK-ut. U thashë se sikur të kishim mundësi do ta ndalonim hyrjen e çdo produkti serb në Kosovë. A mund ta imagjinoi reagimin e izraelitëve nëse dikush do të përpiquej të fuste në vendin e tyre produkte që kanë simbolin e kryqit të thyer të Hitlerit? E njëjta gjë vlen edhe për ne. Serbia ka kryer gjenocid në Kosovë dhe simbolet e këtij shteti janë simbole të shtetit që kreu gjenocidin në Kosovë.

Të nesërmen e takimit i shoqërova në Komunën e Rahovecit. Atje patën mundësi të shihnin një pjesë të vogël të tragjedisë së madhe të shqiptarëve. Pas kësaj vizite, senatorja Anne-Marie Lizin më tha, në prani delegacionit: "Edhe sikur ajri i pastër të vinte vetëm nga Serbia dhe jeta ime të ishte e varur prej tij, të isha shqiptare nuk do ta blija! Do të më dukej përbuzje ndaj të gjitha viktimave!".

As në kohën kur nuk kishim asgjë nën kontroll, e as më vonë kur kërkesa për bojkotin e mallrave serbe u bë një nga kauzat e Lëvizjes Vetëvendosje, bojkoti

nuk u realizua! Të shpresojmë që këto masa shtetërore do ta nxisin vetëdijesimin e njerëzve që ta ndërpresin kontributin financiar për shkatërrimin e shtetit të Kosovës. Të jeni të bindur se në atë moment kur Serbia nuk do të ketë fitime nga Kosova, ajo do të heqë dorë nga financimi i politikës shkatërruese në Kosovë.

**Nuk ka asnjë forcë dhe asnjë presion që detyron qytetarin e Kosovës të blejë produkte serbe**

**"Epoka e re":** Është për t'u habitur se me çfarë shpejtësie reagoi zonja Federica Mogherini, e cila në emër të BE-së kërkoi që

taksat të hiqeshin menjëherë. A mendoni se Kosova do të ballafaqohet me presione nga BE-ja dhe institucionet e tjera ndërkombëtare?

**Mahmuti:** Të gjitha institucionet e shtetit serb janë mobilizuar maksimalisht për ta paraqitur Serbinë si viktimë. Vendimi i Qeverisë së Kosovës është vendim i peshuar mirë dhe nuk ka asgjë që mund të jetë në kundërshtim me Marrëveshjen për Tregti të Lirë të Evropës Qendrore. Asnjë masë nuk është e tepërt për ata që e cenojnë lirinë e popullit të Kosovës apo që i bëhen pengesë shtetit të Kosovës për anëtarësim meritor në institucionet politike, ekonomike, të sigurisë dhe ato kulturore ndërkombëtare.

Megjithatë, presionet ndaj Kosovës nuk përjashtohen. Sidomos nga ata që asnjëherë nuk kanë ngritur zërin kundër padrejtësive dhe shkeljeve të rënda që ka bërë Serbia në mosrespektimin e marrëveshjeve të nënshkruara në Bruksel. Pa marrë parasysh se nga kush dhe të cilës natyrë do të jenë presionet ndaj institucioneve të shtetit të Kosovës, një gjë është e sigurt: nuk ka asnjë forcë dhe asnjë presion që detyron qytetarin e Kosovës të blejë produkte serbe! Sido që të zhvillohen ngjarjet, çdo shqiptar duhet t'u thotë njëherë e përgjithmonë jo produkteve serbe! Të mos bëhemi financues të shkatërrimit të ardhmërisë sonë dhe gjeneratave që vijnë pas nesh!

## Vitin tjetër do të blihen edhe 1 300 shtretër për QKUK-në

**EPOKA  
ERE**

**Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, 23 NËNTOR** - Drejtori i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (ShSKUK), Basri Sejdiu, ka mbajtur të premtën një konferencë për media, në të cilën ka folur për reformat që janë duke ndodhur në institucionet publike shëndetësore në Kosovë. Me këtë rast, drejtori Sejdiu ka folur edhe për shtretërit që janë blerë për klinikat e QKUK-së, me qëllim të përmirësimit të kushteve për pacientët. Duke folur për funksionalitetin e tyre, drejtori Sejdiu ka thënë se të gjithë shtretërit të cilët janë blerë janë me standarde evropiane dhe të cilët kanë përmirësuar ndjeshëm hospi-

talizimin e pacientëve në QKUK. "Ne nuk kemi mundur t'i lëmë qytetarët në shtretër me blloqe e dyshekë të vjetër të cilët kanë dekada që nuk janë ndërruar. Prandaj kemi reaguuar menjëherë, duke blerë shtretër modernë, me standarde evropiane dhe të cilët kanë përmirësuar shumë hospitalizimin e pacientëve tanë", ka thënë Sejdiu, duke shtuar se krahas shtretërve për shtrim të pacientëve, kanë blerë edhe dhjetëra shtretër transportues të cilët do të përdoren për bartjen e pacientëve nga një repart në tjetrin. Ai ka thënë se shtretërit janë blerë të dimensioneve të ndryshme dhe u janë shpërndarë të gjitha klinikave. "Për shkak të specifikave të patologjive, ne

kemi blerë shtretër me disa thyerje në mënyrë që pacienti të ketë mundësi t'i përshtatë qëndrimin e trupit ashtu siç ka nevojë", ka thënë Sejdiu. Ai ka shtuar se blerja e shtretërve do të vazhdojë edhe në vitin 2019. "Këtë vit kemi blerë 750 shtretër, kurse vitin tjetër synojmë të blejmë edhe 1 300 të tjerë. Do të blejmë shtretër edhe për spitalet e përgjithshme. Janë ditë të mira këto që po vijnë për shëndetësinë e Kosovës, pasi shumë reforma po ndodhin në të njëjtën kohë", ka thënë Sejdiu. Ai ka përmendur edhe investimet që do të ndodhin për rinovimin e klinikave të QKUK-së, për transformimin e këtij institucioni në një institucion modern spitalor.

shumë më aktivë?

**Mahmuti:** Gjithsesi që kërkohet një proaktivitet më i madh dhe përgjegjësi më e lartë shtetërore edhe nga qytetarët e Kosovës. Të mos harrojmë, iniciativat për bojkotin e produkteve serbe kanë qenë ë pranishme edhe para edhe pas luftës çlirimtare të Kosovës por, fatkeqësisht, asnjëherë nuk patën efektin që do të duhej të kishin.

**"Epoka e re":** A mund të na sqaroni se në cilën kohë para luftës çlirimtare të Kosovës dhe kush ka ndërmarrë iniciativë për bojkotin e produkteve serbe?

**Mahmuti:** Në kulmin e fushatës antishqiptare të Serbisë nën udhëheqjen e Millosheviqit për ta hequr autonominë e Kosovës, në kohën kur minatorët e Trepçës filluan grevën e përgjithshme dhe u shndërruan



Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë ka publikuar raportin "Barometri Kosovar i Sigurisë: Edicioni i tetë"

## FSK-ja dhe policia, institucionet më të besuara në Kosovë



Institucionet e sigurisë vazhdojnë të jenë më të besuarat në Republikën e Kosovës. Sipas "Barometrit Kosovar të Sigurisë" të publikuar të premten nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 77 për qind e të anketuarve janë shprehur se i besojnë FSK-së, kurse në vend të dytë vazhdon të jetë policia, së cilës i besojnë 61 për qind e qytetarëve. Institucionet e drejtësisë, sipas këtij barometri, vazhdojnë të kenë besim të ulët të qytetarëve

të anketuarve kanë shprehur besimin e tyre në Kuvendin e Kosovës. Krahas këtyre, Qeveria e Kosovës është radhitur si institucioni më i jobesueshëm për qytetarët e Kosovës. Vetëm 14 për qind e qytetarëve kanë thënë se i besojnë Qeverisë së Kosovës. Ky barometër ka regjistruar besim më të madh për institucionet lokale, ku rreth 40 për qind e qytetarëve janë shprehur se u besojnë këtyre institucioneve.

Sa i përket besimit në institucione ndërkombëtare, besimi i qytetarëve ndaj EULEX-it vazhdon të jetë shumë i ulët krahasuar me KFOR-in. KFOR-i listohet si institucioni i dytë më i besueshëm në këtë edicion të barometrit, ku 68 për qind e respondentëve kanë theksuar se i besojnë këtij institucioni ndërkombëtar.

Barometri nuk ka regjistruar ndonjë ndryshim të madh në rezultate sa i përket lidhshmërisë në mes besimit si dhe zonës së vendbanimit. Po ashtu, nuk është vërejtur ndonjë ndryshim i madh sa iu përket regjioneve, përveç në Mitrovicë të Veriut, ku besimi në institucionet e Kosovës është dukshëm më i ulët.

Ngjashëm edhe tek analizimi i lidhshmërisë së besimit me përkatësi etnike, qytetarët serbë vazhdojnë të kenë besim të ulët në institucionet e Kosovës.

Përveç matjes së besimit ndaj institucioneve të sigurisë, BKS-ja ka bërë edhe matjen e perceptimeve të qytetarëve të Kosovës edhe lidhur me kërcënimet kryesore të brendshme dhe të jashtme të sigurisë. Të anketuarit i shohin korrupsionin, papunësinë, krimin e organizuar si rreziqet më të mëdha të brendshme të Kosovës. Mirëpo, shqetësim i madh është vërejtur edhe për ndarjen e Kosovës si dhe autonominë e veriut.

Analizat e kombinuara të barometrit kanë treguar se të anketuarit në zona rurale janë më të shqetësuar rreth rreziqeve të brendshme të Kosovës sesa të anketuarit në zona urbane. Po ashtu, respondentët serbë të Kosovës ndihen më pak të kërcënuar nga të gjitha rreziqet nacionale të sigurisë sesa respondentët shqiptarë, mirëpo të dy etnitë shprehën shqetësim të theksuar lidhur me krimin e organizuar.

Perimetri i sigurisë është një element si dhe tregues mjaft interesant i sigurisë publike në

Kosovë.

Perimetri i sigurisë ka treguar që të anketuarit ndihen më të sigurt në shtëpitë e tyre ose në lagje, krahasuar me fshatin/ qytetin ose Kosovën në përgjithësi. Sipas të dhënave të këtij viti, qytetarët e Kosovës ndihen më së të sigurt në shtëpitë e tyre. 85.5 për qind e të anketuarve kanë thënë se ndihen shumë të sigurt në shtëpitë e tyre. Krahas kësaj, 84.9 për qind kanë raportuar se ndihen të sigurt në lagjen e tyre. Nga të dhënat e BKS të vitit 2018, është e qartë se ndjenja e sigurisë fillon të zbehet sa më shumë që qytetarët largohen nga ambienti i shtëpisë së tyre, kështu duke u rritur ndjenja e pasigurisë. 78.8 për qind e të anketuarve kanë thënë se ndihen shumë të sigurt në fshatin apo qytetin e tyre, ndërsa vetëm 52 për qind të anketuarve janë shprehur se ndihen të sigurt në Kosovë.

Barometri Kosovar i Sigurisë (BKS) është një program i veçantë përmes të cilit Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë mat perceptimet publike. Ky edicion ka matur besimin e qytetarëve të Kosovës ndaj institucioneve kryesore të sigurisë dhe drejtësisë në vend.

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Institucionet e sigurisë vazhdojnë të jenë më të besuarat në Kosovë. "Barometri Kosovar i Sigurisë", i publikuar të premten nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, ka treguar se qytetarët e Kosovës u besojnë institucioneve të sigurisë më shumë se atyre të drejtësisë ose atyre qendrore. Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) përsëri është radhitur si institucioni më i besueshëm në Kosovë. 77 për qind e të anketuarve janë shprehur se i besojnë FSK-së. Sipas gjetjeve të BKS-së, Policia e Kosovës vazhdon të jetë institucion i besueshëm në sytë e qyte-

tarëve, ku 61 për qind të qytetarëve janë shprehur se i besojnë këtij institucioni. Ndërsa AKI-ja qëndron si institucioni i sigurisë i cili gëzon besimin më të ulët, ku vetëm 20 për qind e të anketuarve kanë thënë se i besojnë këtij institucioni.

Institucionet e drejtësisë vazhdojnë të kenë besim të ulët të qytetarëve.

Qytetarët e Kosovës më shumë i besojnë prokurorisë (31 për qind) sesa gjykatave (27 për qind). Është vërejtur se gratë u besojnë institucioneve të drejtësisë më shumë se burrat. Institucionet qendrore, si Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria e Kosovës, vazhdojnë ta gëzojnë besimin tejet të ulët të qytetarëve. Vetëm 15 për qind e

është mbajtur në ndërtesën e Qeverisë së Kosovës. Sipas njoftimit të AAK-së, Hasani dhe Kelmendi kanë thanë se po i bashkohen kësaj partie për të kontribuar në të mirë të vendit.



## AAK-së i bashkohen dy zyrtarë të AKR-së

PRISHTINË, 23 NËNTOR (ER)-Asamblistja e Kuvendit Komunal në Mitrovicë nga radhët e Aleancës Kosova e Re (AKR), Fidane Hasani, dhe kryetari i Forumit Rinor të AKR-së në nivel vendi, Blerim

Kelmendi, të premten iu kanë bashkuar Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Aderimi i tyre është bërë gjatë një takimi me liderin e AAK-së, njëherësh kryeministrin e vendit, Ramush Haradinaj, i cili

# Arrestohen tre persona të dyshuar për vrasjen e Oliver Ivanoviqit

Policia e Kosovës ka arrestuar të premtën katër persona në veri të vendit, tre prej të cilëve dyshohen se janë të përfshirë në vrasjen e politikanit serb Oliver Ivanoviq. Njeri person është arrestuar meqë ka penguar Policinë e Kosovës gjatë kontrollit në këto lokacione ku janë sekuestruar disa dëshmi të rëndësishme që ndërlidhen me vrasjen e Ivanoviqit



Kurse prokurori i Prokurorisë Speciale, Sylë Hoxha, ka thënë se ky operacion është realizuar për t'i gjetur të dhënat faktike. Ai ka hedhur poshtë mundësinë që aksioni të ketë lidhje me taksën e vendosur ndaj produkteve serbe. Hoxha ka treguar se kontrolli i shtëpive të të arrestuarve është bërë me një urdhëresë të datës 21 nëntor të lëshuar nga Gjykata Themelore. "Prokuroria Speciale e Republikës të Kosovës ka grumbulluar prova rreth këtij rasti dhe sigurisht se ka pasur vështirësi të grumbullimit të tyre. I kemi dëgjuar një numër të konsiderueshëm të dëshmi-

tarëve që janë kryesisht nga pjesa veriore lidhur me këtë rast. Prokuroria Speciale ka ardhur në një përfundim se vetëm me një urdhër kontroll të shtëpive/ banesave të të dyshuarve mund të sigurohet edhe ndonjë provë tjetër lidhur me rastin e vrasjes së Oliver Ivanoviqit", është shprehur Hoxha. Njëpërmjet një komunikate për medie Qeveria e Kosovës ka vlerësuar se operacioni policor në veri ka qenë në pajtim të plotë me ligjin, konform urdhrat të Prokurorisë Speciale dhe nuk ndërlidhet në asnjë mënyrë me asnjë zhvillim politik. Qeveria i ka siguruar qytetarët se shteti i Kosovës dhe organet e tij të rendit në asnjë mënyrë dhe asnjëherë nuk do të orientohen kundër asnjë grupi etnik apo politik. "Qeveria e Republikës së Kosovës deklaroi se aksioni policor në veri të Kosovës, që ndërlidhet me ndalimin e disa të dyshuarve për vrasjen e politikanit Oliver Ivanoviq, është realizuar me urdhër të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Me këtë rast, Qeveria e Kosovës u bënë thirrje të gjithë qytetarëve, subjekteve politike, kryetarëve të komunave, posaçërisht atyre në veri dhe organeve të tjera, që të kontribuojnë për mbajtjen dhe

avancimin e qetësisë publike, në shërbim të paqes dhe stabilitetit. Është me rëndësi që askush të mos bie pre e dezinformatave të ndryshme. Ruajtja e rendit dhe respektimi i ligjit është në interes të të gjithëve në Kosovë", është thënë në deklaratën e Qeverisë së Kosovës.

Për arrestimin e këtyre personave, zyrtarë të Qeverisë dhe Presidencës së Serbisë kanë thënë se pjesë e aksionit në veri kanë qenë edhe KFOR-i dhe FSK-ja, mirëpo një gjë e tillë është demantuar nga KFOR-i dhe zëvendësministri i FSK-së, Burim Ramadani. "Nuk kishte asnjë veprim të paligjshëm ose ushtarak. Nuk kishte asnjë kërcënim për sigurinë e vendit dhe sigurinë e qytetarëve. KFOR-i konfirmon se ajo që ndodhi ishte vetëm një operacion policor dhe as FSK-ja e as ndonjë forcë tjetër ushtarake nuk është dërguar në veri të Kosovës", është thënë në komunikatën e KFOR-it. Ndërsa zyrtarët e Bashkimit Evropian u kanë bërë thirrje institucioneve të Kosovës që të bëjnë gjithçka që është nën pushtetin e tyre për të sjellë para drejtësisë autorët e vrasjes së Ivanoviqit. Politikanit serb, Oliver Ivanoviq, është vrarë më 16 janar 2018, para selisë së partisë së tij në Mitrovicën Veriore.

EPOKA  
ERE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Katër persona janë arrestuar të premtën në veri të Mitrovicës nga Policia e Kosovës, nën dyshimin se tre prej tyre janë të përfshirë në vrasjen e politikanit serb Oliver Ivanoviq, kurse një person është arrestuar për shkak se ka penguar zyrtarët policorë gjatë kontrollit dhe arrestimit të dyshuarve. Po ashtu, policia ka bërë me dije se një person me inicialet M. R. mbetet në kërkim. "Personat e arrestuar janë: N. S. (1976), zyrtar policor në veri të Mitrovicës; M. R. (1993), D. M. (1970), zyrtar policor në veri të Mitrovicës dhe A. C. (1965). Mbetet në kërkim policor personi M. R. (1978)", është theksuar në njoftimin e policisë. Kundër arrestimit të këtyre personave dhe vendosjes së taksës ndaj mallrave serbe kanë protestuar serbët e komunave

veriore të Kosovës në Rudarë të Komunës së Zveçanit. Në një konferencë për medie, drejtori i Departamentit për Hetime në Policinë e Kosovës, Riza Shillova, e ka quajtur të suksesshëm këtë operacion. Ai ka thënë se gjatë realizimit të tij nuk ka pasur të lënduar dhe çdo gjë ka shkuar sipas planit. "Cak i operacionit policor kanë qenë katër lokacione dhe katër të dyshuar. Një nga të dyshuarit M. R. nuk është gjetur në vendbanimin e tij, prandaj për të është lëshuar fletarrestim dhe kur të gjendet do të arrestohet. Operacioni ka rezultuar të jetë i suksesshëm. Gjatë operacionit nuk kemi pasur asnjë të lënduar. Të dyshuarit janë përkohësisht në objektet e policisë dhe do të vazhdojë procedura ashtu siç parashihet me Kodin e Procedurës Penale dhe sipas udhëzimeve që i jep prokurori", ka deklaruar Shillova.



## Në kryeqytet vazhdon aksioni për largimin e mallrave serbe me mbishkrime antikushetuese

PRISHTINË, 23 NËNTOR (ER) - Inspektorët e rendit komunal të Prishtinës për të tretën ditë me radhë kanë vazhduar aksionin për largimin e mallrave të importuara nga Serbia që i drejtohen

Kosovës si "Kosove dhe Metohi", "Kosovo Unmik", "Kosovo 1244", "Kosove Rezoluta 1244", si dhe me emërtime të tjera në kundërshtim me emrin kushtetues të shtetit tonë. Gjithashtu, janë

larguar edhe mallrat që si adresë kanë një qytet të caktuar, e jo Republikën e Kosovës. Aksioni do të vazhdojë nëpër secilën pikë të shitjes brenda territorit të kryeqytetit.



# Tektonikat gjeopolitike e diplomatike në Ballkan dhe Kosova



Prof. Lisen BASHKURTI

Zhvillimet e ndodhur në kohën e fundit në Kosovë po dëshmojnë për tronditje të pozitive ndërkombëtare të saj. Në mënyrë të veçantë votimet e dështuara të Kosovës në dy agjenci të Kombeve të Bashkuara, UNESCO dhe INTERPOL, janë treguesit më të matshëm të tronditjes së reputacionit ndërkombëtar të Kosovës dhe të luhatjes së besueshmërisë ndaj institucioneve dhe udhëheqjes së saj. Në një shkrim tulin të përpara disa ditëve kam analizuar shkaqet e brendshme dhe ato rajonale që kanë sjell këtë pozitë të padëshirueshme për shtetin e Kosovës. Në atë shkrim rendita këto shkaqet: agresiviteti në rritje i lobimit serb kundër pavarësisë së Kosovës; konfuzioni i politikës së jashtme të Kosovës dhe plogështia e amatorizmit diplomatik të saj; niveli i pakënaqshëm i bashkëpunimit Shqipëri - Kosovë në fushat e politikës së jashtme dhe diplomacisë; dobësitë në sundimin e ligjit dhe të rendit në Kosovë; si dhe mosadresi mi ligjor i akuzave për krimet e luftës dhe të pasluftës nga gjykatat kombëtare dhe ndërkombëtare.

Duke pasur parasysh se jetojmë në një kohë kur ndërvarësia e shteteve është rritur së tepërmi, kur tendencat globale dhe integruese kanë zbehur natyrën dhe rolin e shteteve, sidomos të shteteve të vogla, kur ka ndryshuar së tepërmi vendi dhe roli i fuqive të mëdha në punët botërore, është objektivisht e domosdoshme të konsiderojmë edhe faktorë jashtë Serbisë, Kosovës dhe Shqipërisë që kanë ndikuar dhe ndikojnë në dinamikat politike në Ballkan.

Rritja e agresivitetit politiko-diplomatik ndërkombëtar serb kundër Kosovës dhe rrëshqitja prapa e politikës së jashtme në kaos dhe e diplomacisë së Kosovës në amatorizëm e plogështi janë ndikuar edhe nga dinamikat tektonike gjeopolitike në Ballkan. Aktualisht ka tri tendenca gjeopolitike kontroverze në Ballkan që nuk e favorizojnë si më parë Kosovën dhe kërkojnë reflektime serioze nga ana e saj.

## 1. Ndryshimet e prioriteteve gjeopolitike të ShBA-së

Tendencat e ShBA-së për zhvendosje graduale të prioriteteve gjeopolitike nga Ballkani ka nisur në kohën e administratës Obama. Presidenti Obama lansoi rrëshqitjen e prioriteteve gjeopolitike të ShBA-së nga Ballkani drejt Lindjes së Mesme, duke u fokusuar në adresimin e krizës nukleare me Iranin dhe krizës komplekse me Sirinë. Bazuar në këtë proces të ri gjeopolitik të ShBA-së, administrata e presidentit Trump avancoi edhe më shumë, duke zhvendosur prioritetet gjeopolitike të ShBA-së nga Lindja e Mesme drejt

Lindjes së Largët, me fokus kryesisht krizën nukleare me Korenë e Veriut dhe luftën tregtare me Kinën. Kjo nuk duhet marrë si tërheqje e plotë e ShBA-së nga Ballkani dhe as si ndryshim i politikave euroatlantike dhe i partnerëve të saj strategjikë në rajon. Kjo qartësisht duhet lexuar vetëm si zhvendosje prioriteteve gjeopolitike. Dhe është normale. Si fuqi botërore, ShBA-ja lëviz prioritetet gjeopolitike në përputhje me interesat madhore dhe sfidat globale të veta. Natyrisht kjo dinamikë gjeopolitike e ShBA-së, ose e thënë më drejtpërdrejt kjo zhvendosje e prioriteteve gjeopolitike të ShBA-së nga Ballkani drejt Lindjes së Mesme dhe Lindjes së Largët, ka ndikime të konsiderueshme në Ballkan, në Kosovë dhe te mbarë faktori shqiptar.

Duke pasur parasysh specifikat e shtetit të ri të Kosovës, sfidat e brendshme shtetformuese, dialogun e komplikuar me Serbinë si dhe pozitën e saj ndërkombëtare ende të pakonsoliduara, mund të merret me mend se çfarë konsekuencash ka dhe do të ketë mbi shtetin e Kosovës pesha e pranisë dhe rolit të ShBA-së në Ballkan edhe për shumë kohë. Krahas sfidave të Kosovës, gjendja e sigurisë në Ballkan, shtetet e dobëta, demokracitë në tranzicion, ekonomitë e paqëndrueshme, problemet dypalëshe dhe ato rajonale janë sfida të tjera, adresimi i të cilave do të varet shumë nga prania dhe roli i ShBA-së në Ballkan.

Normalisht, lëvizja e prioriteteve gjeopolitike të ShBA-së nga Ballkani drejt Lindjes së Mesme dhe të Largët, kërkon rritjen e përgjegjësisë dhe kontributeve të faktorëve lokalë, rajonalë dhe evropianë në Ballkan. Për Kosovën rritja e përgjegjësisë dhe kontributeve individuale është një sfidë serioze që kërkon fuqizimin e aftësive shtetformuese dhe të kapaciteteve drejtuese të saj.

## 2. Diplomacia e ShBA-së në Ballkan, më rajonale dhe më e balancuar

Në këtë fazë, krahas fenomenit të zhvendosjes së prioriteteve gjeopolitike të ShBA-së drejt Lindjes së Mesme dhe të Largët, vërehen edhe dinamika të tjera të diplomacisë së ShBA-së brenda Ballkanit. Për një periudhë të caktuar kontributi i ShBA-së në Ballkan u fokusua në ndalimin e luftërave dhe vendosjen e paqes (1994-1995, konfliktet Kroaci, Serbi, Bosnje dhe Akordi i Paqes i Dejtonit). Më tej ShBA-ja u fokusua në shembjen e diktaturave, duke ndaluar krimet, gjenocidin, pastrimet etnike dhe shndërrimin e krizave lokale në konflikte të mëtejshme ballkanike (Serbia e Kosova, 1998-2008, Rezoluta 1244 e KS të OKB-së dhe më pas Paketa e Ahtisarit dhe pavarësia e Kosovës). Aktualisht, ShBA-ja po shkon drejt një qasje me baza më rajonale dhe diplomatikisht më të balancuar. Pra, tanimë në optikën e politikës së jashtme dhe diplomacisë së ShBA-së, Sllovenia, Kroacia, Serbia, Bosnja, Mali i Zi, Maqedonia dhe Kosova po vihen në një kontekst gjithnjë e më të

përbashkët rajonal. Kjo do thotë se Kosova nuk mund të vijojë të jetë më projekt individual prioritar i ShBA-së, ndonëse mbetet për shumë kohë partnere e rëndësishme strategjike e tyre. Koncepti më shumë rajonal sesa individual i politikës së jashtme dhe diplomacia më e balancuar e ShBA-së në Ballkan kërkon edhe nga aktorët shtetërorë në rajon që ta ndryshojnë qasjen e tyre të deritanishme drejt një diplomacie më të hapur dhe më bashkëpunuese, duke ekuilibruar më mirë interesat shtetërore me ato rajonale.

Ky ripozicionim i diplomacisë së ShBA-së kërkon reflektime serioze dhe të shpejta edhe në Kosovë. Për Kosovën kjo do të thotë përpilim dhe implimentim i një politike të jashtme mbi baza më të qarta dhe më të qëndrueshme strategjike kushtetuese dhe institucionale, bashkëpunuese dhe konsuesale, atdhetare dhe Evropiane e shoqëruar me një diplomaci të aftë e dinamike, me formim profesional dhe përvojë, me kulturë dhe integritet, me kapacitetet negociuese dhe implementuese në nivele bilaterale dhe multilaterale.

Për rreth 15 vjet Kosova ishte projekt politiko-diplomatik prioritar i ShBA-së në Ballkan, edhe një lloj protektoriat sui generis i saj mbi të. Tanimë kjo fazë ka mbaruar. Për ShBA-në, Kosova nuk është më protektorat, por është një aleat. Pra, ShBA-ja nuk e braktis aspak Kosovën, por kërkon ngritjen në një fazë më të lartë të marrëdhënieve me të. Për këtë përgjegjësia kryesore bie mbi shtetin e Kosovës dhe lidhshiptin e saj. Është koha kur shteti i Kosovës dhe lidhshipti kosovar duhet të marrin më shumë përgjegjësi shtetërore, rajonale dhe ndërkombëtare, nëpërmjet një politike të jashtme strategjike dhe kapaciteteve të afta diplomatike.

Qasjen më rajonale dhe të balancuar si dhe më pak individuale të ShBA-së në Ballkan, Serbia e ka mirëpritur. Kjo është e natyrligje. Tanimë Serbia ndihet e baraskonsideruar në agjendën e ShBA-së sa i përket Ballkanit. Por, nëse ka ta drejtë ta mirëpresë qasjen e re të ShBA-së, Serbia nuk ka aspak të drejtë ta keqinterpretojë atë. Politika e diplomacia serbe po e interpretojnë qasjen e re më rajonale dhe më të balancuar të ShBA-së në Ballkan, si 'heqje dorë të ShBA-së nga Kosova', ose si 'mbështetje të ShBA-së për Serbinë'. Ky është gabim.

Me këtë taktikë Serbia synon të arrijë tre objektiva: së pari, ta dekurajojë shtetin e Kosovës; së dyti, t'i hapë rrugën ballkanike Rusisë; së treti, të nxisë një lobim më agresiv kundër pavarësisë së Kosovës për t'i bllokuar njohjet dhe integrimin ndërkombëtar të saj. Egoizmi politiko-diplomatik serb po shpërdoron dinamikën gjeopolitike e diplomatike të ShBA-së. Idealizmi i ShBA-së jo gjithnjë është mirëkuptuar në mjediset e mbrapshta ballkanike. Por, natyrisht, ShBA-ja ka aq përvojë tash 100 vjet në Evropë dhe Ballkan sa nuk mund të mos e kuptojë këtë mjedis të amuar ballkanik dhe këto dinamikë politiko-diplomatike euro-aziatike serbe.

## 3. Zhvendosje prioriteteve gjeopolitike ruse drejt Ballkanit

Zhvendosja e prioriteteve strategjike të ShBA-së nga Ballkani drejt Lindjes së Mesme dhe Lindjes së Largët ka krijuar një lloj vakuumi të pranishëm dhe rolit të tyre në këtë rajon. Ndërkohë, duke përfutur edhe nga kjo zhvendosje gjeopolitike e ShBA-së dhe konjunkturën rajonale dhe evropiane, gjeopolitika ruse po rrëshqet gradualisht drejt Ballkanit. Gjeopolitika ruse synon ta mbush vakuumin e zhvendosjes së ShBA-së drejt Lindjes së Mesme dhe të Largët, nëpërmjet aktivizimit të doktrinave tradicionale dhe të favorizimit të politikave, investimeve dhe strategjive drejt shteteve dhe popujve preferencialë. Pra, nëse ShBA-ja po zgjeron qasjen rajonale dhe redukton qasjen individuale në Ballkan, Rusia është duke zhvilluar qasjen preferenciale në shtete individuale dhe është duke reduktuar qasjen rajonale. Qasjet e ShBA-së dhe Rusisë në Ballkan duket të jenë të kundërta. Qasja rajonale e ShBA-së synon t'i trajtojë njëllë dhe miqësisht gjithë popujt e vendet e Ballkanit. Qasja preferenciale individuale e Rusisë synon t'i trajtojë në mënyrë të diskriminuar dhe jo miqësisht gjithë popujt e vendeve të Ballkanit.

Kjo dinamikë gjeopolitike preferenciale individuale e Rusisë në Ballkan ka premisa diversifikuese dhe konfrontuese të linjave të politikës së jashtme të vendeve të Ballkanit ndërmjet tyre. Kështu, rajoni mund të devijojë nga tendencat unifikuese deri të tanishme euroatlantike në orientime diverse e kontraktore euro-aziatike. Kjo tendencë, për arsye që njihen mirë kombëtarisht e ndërkombëtarisht, është kundër unifikimit euro-atlantik të Ballkanit, sikundër nuk është aspak në favor të Kosovës dhe të shqiptarëve, sa kohë që Kosova dhe shqiptarët përgjithësisht nuk konsiderohen ndër popujt e shtetet preferenciale të Rusisë në Ballkan.

## 4. Dilemat gjeopolitike evropiane në Ballkan

Midis tërheqjes relative të ShBA-së nga Ballkani dhe rritjes së ndërhyrjes ruse në këtë rajon, Bashkimi Evropian po përpiqet ta risë praninë dhe investimin e vet në Ballkan. Kjo është në interes të të gjithë vendeve të rajonit. Iniciativat e shteteve të veçanta si Gjermania me Procesin e Berlinit, apo politikën e gjallëruara të Bashkimit Evropian për zgjerim në drejtim të Ballkanit Perëndimor në tërësi, janë mirëpritur dhe mbështetur nga të gjithë aktorët shtetërorë dhe joshetërorë ballkanikë.

Ky dinamizim i BE-së ka dy impakte gjeopolitike pozitive në Ballkan. Së pari, po ekuilibron më mirë ndryshimet gjeopolitike dhe politiko-diplomatike të ShBA-së në Ballkanit; së dyti, po ngushton hapësirat e faktorëve gjeopolitike jashtë euro-atlantikë që synojnë të përfitojnë nga këto konjuktura të fuqive të mëdha. Dinamizimi i

BE-së në Ballkan po synon mbështetjen e demokracive në tranzicion, normalizimin e marrëdhënieve të tyre fqinjësore dhe nxitjen e projekteve interkonektive në ekonomi, tregti, turizëm, infrastrukturë bazuar në parimet e Traktatit të Lisbonës. Ky kontribut i BE-së po jep shenja mjaft pozitive. Projekti i BE-së ende po i frymëzon dhe motivon popujt dhe politikën e Ballkanit. Nëse evropianizimi do të vijojë të dominojë mbi tendencat nacionaliste, populiste e fobiste në zgjedhjet e ardhshme, BE-ja pa dyshim do ta përshpejtojë zgjerimin drejt Ballkanit Perëndimor.

Por, Bashkimi Evropian ka një sfidë të brendshme - nuk ka një politikë të jashtme, diplomaci dhe siguri të unifikuar. Në politikën e jashtme, diplomaci dhe siguri brenda BE-së në disa aspekte ka qasje unike, në aspekte të tjera ka qasje të ndryshme sikundër nuk mungojnë edhe qasjet e kundërta. Përballë kësaj situatë kontroverze brenda BE-së, organizata është e detyruar politikisht e diplomatikisht të mbajë qëndrime neutrale në kuadër rajonal dhe ta shmangë çdo politikë preferenciale. Në rastin e marrëdhënieve Serbi - Kosovë, neutraliteti politiko-diplomatik i BE-së është problematik. Neutraliteti politiko-diplomatik i BE-së në qasjen Kosovë - Serbi i zgjatë pa afat Serbisë rrugën e anëtarësimit në BE. Ndërkohë që neutraliteti politiko-diplomatik i BE-së në qasjen Kosovë - Serbi i zgjatë pa afat marginalizimin dhe izolimin.

Por, në analizë të fundit, nga ky neutralitet politiko-diplomatik i BE-së përfitojnë më shumë shtetet e konsoliduara, ekonomitë e stabilizuara dhe vendet më të avancuara në proceset e integritit. Gjithashtu, duhet marrë mirë parasysh se nga ky neutralitet i BE-së përfitojnë më së paku shtetet e reja, shtetet e dobëta, shtetet në tranzicion të tejzgatur dhe popujt me problematika më të shumta në Ballkan. Në këtë rast Kosova si shtet i ri dhe i panjohur nga pesë shtetet anëtare të BE-së si dhe shqiptarët përgjithësisht, për shkak të trashëgimive problematike historike dhe të dobësive aktuale, nuk do të mund të jenë përfituesit kryesorë evropianë në Ballkan, së paku për një periudhë të caktuar.

Në këto rrethana për Kosovën, Shqipërinë dhe shqiptarët përgjithësisht mbetet strategji afatgjatë ruajtja e prioritizimit në çdo mënyrë, çdo mjet dhe çdo sakrificë e partneritetit strategjik me ShBA-në, njëkohësisht përmirësimi i balancimit të këtij partneriteti me Bashkimin Evropian. Kosova, Shqipëria dhe shqiptarët sërish kanë një mision historik të shërbejnë si bazë e fuqishme unifikuese dhe jo diversifikuese euroatlantike në Ballkanin Perëndimor dhe si urë e qëndrueshme lidhëse dhe jo përçarëse e partneritetit BE - ShBA në këtë rajon. Me këtë kontribut Kosova, Shqipëria dhe faktori shqiptar në Ballkanin Perëndimor kontribuojnë në zgjerimin dhe konsolidimin e hapësirave gjeopolitike euro-atlantike në këtë rajon dhe në fuqizimin e hapësirave të faktorëve të tjerë gjeopolitike rajonalë dhe globale.



# Qeveria kërkon të ndërpriten reduktimet e energjisë

EPOKA  
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Qeveria e Republikës së Kosovës i konsideron zhgënjyese dhe të patolerueshme ndërprerjet e energjisë elektrike ditët e fundit. Në një komunikatë për media të ekzekutivit, thuhet se "është e patolerueshme sjellja e Distribucionit të Furnizimit me Energji Elektrike (KEDS) dhe Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) në ditët e para të dimrit, duke i shtyrë qytetarët të përballen me reduktime të ashpra të energjisë elektrike". "Menaxhmenti i KEDS-it dhe KEK-ut duhet ta dinë se Qeverisë së Kosovës dhe qytetarëve të saj nuk u intereson se cili njësit është funksional e cili jo dhe as nuk i intereson se cili është çmimi i energjisë në tregun ndërkombëtar, por kanë obligim dhe janë të thirrur të sigurojnë energji elektrike për të gjithë

qytetarët e Kosovës", thuhet në komunikatën e Qeverisë së Kosovës.

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka sqaruar se nuk ka asnjë përgjegjësi sa i përket furnizimit të konsumatorëve me energji elektrike dhe reduktimeve që po ndodhin, pasi furnizues publik nga viti 2013, sipas licencës, është KEDS/KESCO. KEK-u ka njoftuar se që nga viti 2013 përgjegjësinë ekskluzive e ka vetëm për prodhim të energjisë elektrike dhe eksploatim të thëngjillit. "Furnizues publik (furnizues i shërbimit universale) nga viti 2013, sipas licencës, është KEDS/KESCO. Ky operator ka përgjegjësi dhe obligim për furnizimin e qytetarëve me energji elektrike, ndërsa KOSTT-i është përgjegjës për balancimin e sistemit të energjisë elektrike. Prandaj, për reduktimet apo mungesën e energjisë elektrike të konsumatorëve duhet të japin llogari ata të cilët janë të licen-



tuar dhe kanë këto obligime", thuhet në reagimin e KEK-ut.

Sipas obligimeve dhe rregullave të tregut, KEK-u, me kohë, 24 orë

më herët, i ka njoftuar operatorët për këtë ndalesë.

## Klubi i Prodhuesve të Kosovës bën thirrje për mosngritje të çmimeve



PRISHTINË, 23 NËNTOR (ER) - Klubi i Prodhuesve e ka përkrahur dhe mirëpritur vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratimin e vendimit të ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, që produkteve të importuara nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina t'u vihet taksë prej 100 përqindësh. "Klubi i Prodhuesve e përkrah një vendim të tillë kur kihen parasysh pengesat e vazhdueshme që këto dy shtete ua kanë bërë produkteve të Kosovës për depërtimin në tregjet e tyre, e

që në masë të madhe ka dëmtuar prodhuesit e Kosovës, duke i bërë jokonkurues. Mirëpo, në të njëjtën kohë, Klubi i Prodhuesve të Kosovës u bënë thirrje të gjithë operatorëve ekonomikë mos t'i ndryshojnë çmimet e tregut, duke i rritur ato pas miratimit të vendimit për taksën 100 për qind për produktet e Serbisë dhe Bosnjës", është thënë në deklaratën për media. Klubi i Prodhuesve i ka ftuar të gjithë t'i përkrahin interesat e vendit dhe t'i mbrojnë qytetarët, kur kemi parasysh gjendjen

ekonomike të shumicës së qytetarëve. "Masën për mbrojtjen e prodhimit prej 100 përqindësh të Qeverisë së Republikës së Kosovës të gjithë operatorët ekonomikë duhet ta shohin si mundësi për zhvillimin dhe fuqizimin ekonomik të vendit dhe jo si situatë për përfitim. Klubi i Prodhuesve të Kosovës beson se ky vendim do t'i mbrojë interesat e prodhimeve vendore dhe përbën një lehtësim për prodhuesit vendorë", është thënë në deklaratën e Klubit të Prodhuesve.

## Ministri Shala nënshkruan deklaratën për bashkëpunim me vendet e EFTA-s

EPOKA  
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, në Gjenevë, në prani të ministrave homologë, atij të Zvicrës, të Norvegjisë, të Lihtenshtajnit dhe të Islandës, ka nënshkruar deklaratën e përbashkët për bashkëpunim me këto katër vende anëtare të EFTA-s. Ky dokument me rëndësi strategjike për Republikën e Kosovës parashihet thellimin e bashkëpunimit ekonomik me EFTA-n dhe gjatë vitit 2019, edhe fillimin e negociatave për Marrëveshje të Tregtisë së Lirë me vendet e EFTA-s. Ministri Shala ka thënë se sot është një moment i jashtëzakonshëm për shtetin e Kosovës dhe

për ekonominë pasi, sipas tij, ky është një hap drejt rrugës për arritjen e nënshkrimit të marrëveshjes për tregti të lirë. "Ky është një moment i jashtëzakonshëm për ne si shtet, për ekonominë tonë, pasi është një hap para në rrugën e duhur derisa ta arrijmë nënshkrimin e marrëveshjes së tregtisë së lirë me këto vende. Një marrëveshje e tillë nënkupton që të gjitha produktet që prodhohen në Kosovë të eksportohen në Zvicër dhe në vendet e tjera të lartpërmendura pa asnjë taksë. Në vazhdim e punës sonë për ta promovuar prodhimin vendor dhe eksportin në tashmë po hapim rrugë dhe po gjejmë partnerë dhe tregje të reja për produktet tona", ka thënë ministri Shala.



## Rregullohet trotuari në rrugën 'George Bush'

Prishtinë, 23 nëntor (ER) - Komuna e Prishtinës ka bërë me dije se ka eliminuar gropat në disa rrugë të kryeqytetit. Kjo komunë ka theksuar se me investime të tilla është duke u synuar përmirësimi i infrastrukturës rrugore në Prishtinë. "Janë

eliminuar gropat në rrugën 'Qëndresa' në Mat, si dhe është rregulluar trotuari në rrugën 'George Bush'. Me intervenime të tilla të vogla po synojmë ta përmirësojmë infrastrukturën rrugore", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.



## Ndahen 56 bursa për studentët dhe nxënësit e Kastriotit

KASTRIOT, 23 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Kastriotit, Xhafer Gashi, ka ndarë 56 bursa për nxënësit dhe studentët e kësaj komune. Gashi ia ka ndarë çmimin "Adem Preniqi" studentes Liridona Pllana e cila ka notën mesatare 10. "Sot pata

nderin dhe kënaqësinë të jem në mesin e nxënësve dhe studentëve të dalluar të komunës sonë, ku së bashku me drejtorin e DKA-s, Agim Spahiun, ndamë 19 bursa për nxënësit e shkëlqyer të Shkollës Profesionale 'Ismail Dumoshi' dhe 37 stu-

dentë në Universitetin e Prishtinës. E veçanta ishte ndarja e çmimit 'Adem Preniqi' për studenten Liridona Pllana, me notën më të lartë mesatare 10. Suksese të gjithëve!", ka shkruar Gashi në llogarinë e vet në Facebook.

## Komuna e Rahovecit liron trotuaret nga mallrat e ekspozuara

RAHOVEC, 23 NËNTOR (ER) - Inspektorati Komunal i Rahovecit ka liru hapësirat publike në qytetin e Rahovecit, me këtë rast pronarëve të lokaleve të cilët e kanë ekspozuar mallin në trotuar u është konfiskuar. Besnik Hoti, drejtor i Drejtorisë për Punë Inspektuese, i cili gjatë gjithë kohës ka qenë së bashku me

inspektorë, ka treguar se deri te fillimi i këtij aksioni ka ardhur duke u bazuar edhe në kërkesat e marra nga qytetarët pasi, sipas tyre, kanë probleme për të ecur nëpër trotuare. "Aksionin për lirim të trotuareve nga mallrat të cilat janë ekspozuar nga shitësit nëpër trotuare e kemi nisur duke u bazuar në kërkesat e marra nga

shumë qytetarë. Para fillimit të aksionit janë respektuar të gjitha procedurat e nevojshme dhe krejt në fund inspektorët komunalë, të asistuar edhe nga Policia e Kosovës, të stacionit në Rahovec, kanë bërë konfiskimin e mallit nga shitësit të cilët nuk i kanë respektuar njoftimet e bëra nga ana e inspektorëve", ka thënë



drejtori Hoti. Ai ka thënë se praktika e zënies së trotuareve në rrugën kryesore të qytetit të

Rahovecit ka vazhduar për disa vjet, por që vazhdimisht inspektorët e drejtorisë për Punë Inspektuese kanë marrë aksione për lirim të trotuareve. Aksione të ngjashme do të ketë në vazhdimësi derisa të mos ketë ekspozim të mallit në trotuare dhe të mos ketë pengesa për lëvizjen e qytetarëve nga ekspozimi i mallit.



## Asfaltohet rruga 'Drita' në Ferizaj

FERIZAJ, 23 NËNTOR (ER) - Kohët e fundit është shtuar dinamika kohore e punëve në Komunën e Ferizajt. Në kuadër të projekteve infrastrukturale, të premtën është asfaltuar rruga "Drita", në të cilën, përveç asfaltimit, qeverisja lokale ka investuar edhe në rregullimin e infrastrukturës nëntokësore. Për ta parë këtë vepër publike që po kryhet me cilësinë më të lartë dhe kushtet më të

avancuara për asfaltimin e rrugëve, ka dalë drejtori i Infrastrukturës, Arbër Bytyqi, bashkë me drejtorin e Urbanizmit dhe Mjedisit, Lulzim Aliu. Ata kanë përshkruar këtë rrugë në gjithë gjatësinë e saj duke vlerësuar punimet që janë bërë këtu. Drejtori i Infrastrukturës, Arbër Bytyqi, ka thënë se kushtet e favorshme atmosferike kanë bërë që të vazhdohet asfaltimi dhe

investimet në infrastrukturën nëntokësore sipas lotit të parë të projektit për asfaltimin e 50 rrugicave të qytetit. "Në kuadër të asfaltimit të rrugicave të qytetit, gjegjësisht në kuadër të lotit të parë të projektit, bëhet fjalë për asfaltimin e rreth 50 rrugicave. Bëhet fjalë për një projekt në vlerë prej 450 mijë eurosh. Do të asfaltohen gjithsej shtatë kilometra rrugë", ka thënë Bytyqi.

## Begaj reagon për ndërprerjet e gjata të rrymës në Malishevë

MALISHEVË, 23 NËNTOR (ER) - Në territorin e Komunës së Malishevës, KEDS-i është duke aplikuar ndërprerje të gjata dhe pa orar të energjisë elektrike. Dhe, rrjedhimisht, janë duke shkaktuar probleme të mëdha si në sektorin e biznesit, po ashtu edhe në institucionet arsimore dhe

në amvisëri. Për këto ndërprerje të premtën ka reaguar kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, i cili ka kërkuar ndërmarrjen e masave për sanimin e kësaj gjendje. Ai ka thënë se ndërprerjet e rrymës janë duke shkaktuar probleme në institucionet shkollore.



# BE-ja presionin drejtojeni ndaj atyre që kanë bërë luftëra e gjenocide në hapësirat e ish-Jugosllavisë



Nga Jakup KRASNIQI

Të gjithë duhet ta dinë se sa u përket marrëdhënieve të Kosovës me Serbinë, politika e politikanët e Kosovës nuk e kanë asnjë përgjegjësi, bile kanë fajë pse janë vonuar t'i bëjnë veprimet e duhura me kohë në raport me politikat agresive të përsëritura shumë herë nga Serbia që nga viti 1912-1999.

Politika dhe politikanët e Kosovës mund të kritikohen për shumë çka që ka të bëjë me shtetndërtimin, zhvillimin e punësimit, por më asnjë kritikë të vetme, nuk mund t'ju bëhet në raport me Serbinë, ndaj politikave të se cilës kanë qenë më tepër se te kujdesshëm në vitet e pas luftës.

Ta shohim pse kanë qenë të kujdesshëm dhe si janë zhvilluar bisedimet Kosovë - Serbi?

1. Politika e Kosovës, në shkurt/mars të vitit 1999, në Bisedimet e Rambujesë e Parisit, ka pas bërë një kompromis të madh prej të cilit na ka pas shpëtuar mospranimi i asaj Marrëveshje nga kriminel Millosheviq. Ishin bombardimet e NATO-s që i shpëtuan shqiptarët nga gjenocidi i Serbisë së Millosheviqit! Ajo politikë po vazhdon edhe sot.

Kosova ndihmën ndërkom-bëtare e vlerëson shumë!

2. Politika e Kosovës në Bisedimet e Vjenës 2006/2007 e ka bërë kompromisin tjetër kur e ka pranuar Dokumentin e Presidentit Ahtisari për Zgjidhjen e Statusit Përfundimtar të Kosovës. Sipas të cilit Dokument, pakica serbe ka të drejta sa edhe shumica shqiptare. Të drejta që nuk i ka asnjë pakicë kombëtare në Evropë. Serbët e Kosovës duhet t'i shfrytëzojnë të drejtat e tyre të dhëna me shumë zemërgjerësi nga politika e Kosovës.

3. Kosova ka bërë kompromisin tjetër të madh, që nuk është dashur ta bëjë, kur ka pranuar që bisedimet teknike të shndërrohen në bisedime politike. Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme e OKB-së e obligonte Kosovën vetëm për bisedime teknike. Nga i cili kompromis nuk ka fituar asgjë! Përkundrazi, agresiviteti i Serbisë në drejtim të Kosovës është shtuar. Provokimet luftënxitëse serbe nuk kanë pushuar asnjë herë, e as viteve të fundit!

Në asnjërin nga rastet e përmendura Politika e Serbisë nuk i ka respektuar, s'po i respekton as marrëveshjet e Brukselit. Madje ajo nuk ka dashur as t'i dëgjoj kërkesat paqësore të shqiptarëve që nga viti 1981-1998! Ndërsa zhvillimet luftarake të viteve 1989/99 të gjithëve na janë të njohura për përmasat shkatërruese e dhimbjet e mëdha njerëzore të shkaktuar në çdo familje shqiptare. Ne, na vije keq pse

për këto politika të gjenocidit, Serbia po gjen mbështetje nga shtete të mëdha të Botës dhe të disa vende të BE-së! Gjithashtu na vije keq, pse politika e gjenocidit serb, ka gjetur mbështetjen nga një pjesë e madhe e botës islame, e cila si shumë thirret në do "vlëra" të mesjetës së hershme?!

Në të gjitha bisedimet e përmendura (sidomos nga viti 1999 e kënde), prezenca e përfaqësuesve të BE-së ka qenë më shumë se fasilituese! Ajo e dinë se kush nuk donë marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve në mes Kosovës e Serbisë! Andaj ajo duhet të jetë fasilitues i drejtë dhe i paanshëm. Nga atëherë e deri më sot, zyrtarët e BE-së i kemi parë të heshtin sa herë ishin në pyetje veprimet agresive të Serbisë!

## Ora e historisë po bie për Qeveritë Shqiptare

Vendimi i Qeverisë se Kosovës për mallrat e Serbisë e të Bosnjës, është më shumë se i vonuar, prandaj duhet të pushoj çdo presion mbi Kosovën. BE-ja duhet ta orientoi presionin mbi Serbinë e cila vazhdon ta ndjek politikën e Millosheviqit. Serbia duhet ta njeh Pavarësinë e Kosovës nëse donë komunikim e marrëdhënie reciproke me shtetin më të ri të Evropës, Republikën e Kosovës. Nëse vërtetë ajo donë respekt të ndërsjellë me shqiptarët!

Zyrtarët më të lartë serbë, jo vetëm që nuk janë distancuar nga ato politika, por u vije keq pse nuk janë vazhduar ato

politika të krimit e të gjenocidit në Kosovë e Bosnje. Kujtoni, ju zotërinjtë e BE-së, fjalimin e paradokohshëm të Vuçiqit në Kosovë e të Kryeministres serbe për gjenocidin serb në Serbrenicë! Atyre ju vinte keq pse nuk ishin realizuar politikat patriotike të Millosheviqit.

Nga kjo që u tha del se as Prishtina e as Brukseli nuk e kanë gjetur gjuhën e vetme që e kuptojnë politikanët e Beogradit. Ata zotërinjtë në Beograd nuk e njohin gjuhën e mirëkuptimit, të bashkëpunimit e të partneritetit, gjuhën e lëvizjes së lirë, gjuhën që sjell paqen e sigurinë për të gjithë në ketë pjesë të Evropës! Gjatë këtyre viteve kemi bërë shumë për paqen.

Brukselit nuk i takon që t'ia mbaj anën Serbisë e politikave të saja të luftës, të krimit e të gjenocidit. BE-ja duhet t'ju përmbahet vlerave të saja të mirënjohura, të paqes, të drejtësisë, të drejtave e lirisë të njeriut, të partneritetit, të lëvizjes së lirë të njerëzve e të mallrave etj! Ne, shqiptarët i njohim dhe i respektojmë ato vlëra.

Nuk ka paqe, liri, drejtësi e demokraci aty ku presioni drejtohet mbi viktimën që ka vuajtur gati 100 vjet dhe amnistohet krimi e gjenocidi i planifikuar, i programuar dhe i ushtruar po aq e më tepër vite mbi shqiptarët në përgjithësi nga Serbia e djeshme dhe e sotshme!

Ne, shqiptarët jemi përcaktuar për paqe e siguri, për shtet të pavarur, sovran e demokratik! BE-ja e din se Parlamenti Evropian e ka njohur pavarësinë e Kosovës në vitin 2008! Prej

atëherë e deri më sot, Kuvendi i Kosovës ka pasur takime të përvitshme me Parlamentin Evropian. Prej atëherë e deri më sot, Kosova i ka heshtur shumë padrejtësi si dhe gjenocidin e djeshëm dhe ketë e ka bërë për hir të paqes për sot e nesër! Është keq pse kjo hapësirë që ju dha paqes nga politika e Kosovës, nuk po kuptohet drejtë as nga Serbia e as nga BE-ja! BE-së nuk ia diktojmë politikën, por jemi te detyruar ta mbrojmë lirinë, pavarësinë e sovranitetin e vendit tonë ndaj kujtdo që na e rrezikon qenien tonë njerëzore e kombëtare!

Nëse zyrtarët e BE-së mund të jenë të ftoftë si akulli për gjenocidin e Serbisë të kryer në Kosovë, gjurmët e të cilit janë më shumë se të freskëta edhe sot, zyrtarët politik dhe qytetarët e Kosovës nuk mund të jenë të pa gjak si hardhuca nën kaçuba e as ta fusin kokën në zall si struci! Politikat e krimit e të gjenocidit në Serbi janë ringjallur!

Në një situatë të tillë, Kuvendi i Kosovës duhet të kërkon nga Qeveria e Kosovës që ta ndërpret shpenzimin e parasë publike për ndërtimin e autostradave, bile ketë duhet ta bëjë edhe Shqipëria, që ato mjete financiare t'i orientojnë për mbrojtje e siguri kombëtare! Ketë duhet t'ua bëjnë të njohur edhe miqve ndërkom-bëtar. Përndryshe, përgjegjësia e tyre para kombit do të jetë tepër e madhe!

Ora e historisë po bie për Qeveritë Shqiptare për t'i shtuar përgjegjësit për sigurinë kombëtare!

## Pallati i Rinisë shndërrohet në Ndërmarrje Publike Lokale

PRISHTINË, 23 NËNTOR (ER)-Komuna e Prishtinës ka marrë lajmin e mirë nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, se Pallati i Rinisë është regjistruar si Ndërmarrje Publike Lokale "Pallati i Rinisë" Sh. A.

Me të marrë këtë lajm, Komisioni i Aksionarëve i përbërë nga Mimoza Sylejmani, Shefqet Osmani dhe Avni Zuka, emëruan katër anëtarët e bordit të drejtorëve: Arben Polloshka, Cuneyd Ustaibo, Arsim Gollaku, dhe Nazmi Kryeziu.

Ky Bord është i përkohshëm, deri në konkursin që do të bëhet në bashkëpunim me Ambasadën britaneze dhe shoqërinë civile. "Tash, me regjistrimin si NPL 'Pallati i Rinisë' Sh. A., krijohet mundësia për hapjen e llogarisë bankare, arkëtimin e të hyrave, dhe si rrjedhojë - sigurimin e pagave për punëtorët. Angazhimi jonë do të orientohet në stabilitetin financiar të ndërmarrjes, investimet dhe rimëkëmbjen e këtij pallati", është thënë në njoftimin e Komunës së Prishtinës.



(Procesi gjyqësor i Prizrenit më 1946 sipas dokumenteve të gjykatave ish-jugosllave. Para trupit gjykues dolën 34 patriotë të cilëve gjyqi ua shqiptoi dënimet: gjashtë veta i dënoi me pushkatim, të tjerët me vite të shumta burg) /30/

# DOKUMENTE INKRIMINUESE TË ONDSH-së



Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA

(Sqarim: Shkrimi në vazhdim botohet pa i bërë redakturë gjuhësore pasi është i shkruar si në dokumentet origjinale)

Se e pandehura Luçija Bashota, ka qenë anëtare dhe sekretare e komitetit të lartpërmendur dhe njëherit Bashkimit të Rinis Komuniste Jugosllave, se ka bërë mbledhjen e armëve dhe materialit tjetër për bandat në mal, dhe gjykata ia ka marrë si shkaqe lehtësire pohimin e saj, pendimin e saj dhe rrethanat se si e re është mashtruar dhe ka hyrë në organizatën ilegale, me që rast e ka dënuar me dënimin e humbjes së lirisë, punë të detyrueshme me vazhdim prej një viti.

Se e pandehura Roza Mjeda ka qenë anëtare e komitetit të lartpërmendur dhe njëkohësisht ka qenë në SKOJ, si anëtare e komitetit ka mbledhë material për bandat dhe gjykata duke ia marrë si shkaqe lehtësire pohimin se është përdoruar për veprën e saj në komitet dhe faktin se si e re është mashtruar e ka hyrë në komitetin e lartpërmendur, e dënon me humbjen e lirisë, me punë të detyrueshme në vazhdim prej një viti.

Se e pandehura Nasibe Zhuri ka qenë anëtare dhe arkëtare e organizatës së lartpërmendur ilegale, ka punuar në mbledhjen e materialit, gjykata duke e marrë parasysh si shkak lehtësues pohimin e saj, pendimin e saj, përpjekjet e saja që çështja të sqarohet, dhe faktin se si e re ka rënë në influencën e vëllait të vet, dhe se prej dashurisë që kishte për të ka hyrë në organizatën ilegale, që me anë të kësaj rruge të ndihmonte materialisht, gjykata e ka ndëshkuar me humbjen e lirisë, me punë të detyrueshme për një vit, ndëshkimi i cili është kondicional dhe i pezullueshëm për një vit, duke konsideruar se ky dënim është i mjaftueshëm që të ndikoj në të pozitivisht dhe që të përmirësohet, kështu që në të ardhmen mos të mbahet në kryerjen e kësaj lloj fajesh.

Se e pandehura Roza Cuki, ka qenë anëtare e komitetit, nuk ka qenë aktive në punë, detyrën e ngarkuar për mbledhjen e materialit nuk e ka kryer plotësisht, andaj Gjykata duke marrë parasysh si rrethana lehtësuese pohimin dhe pendimin, e dënon me një vit të humbjes së lirisë, me punë të detyrueshme, ndëshkimi i cili është kondicional dhe i pezullueshëm për një vit, dhe duke konsideruar se ky ndëshkim është i mjaftueshëm që të jetë shkaktar

pozitiv dhe përmirësues. Gjykata nuk mundet të konstatojë se të pandehurat Qiqile Krasniqi, Mrika Gjoka, Mane Shyti kam bërë pjesë dhe kanë qenë anëtare të komitetit ilegal të lartpërmendur, as për atë që kanë punuar ndonjë gjë.

Gjykata konstaton se të pandehurat Qiqilija, Manja dhe Mrika kanë qenë të mashtruara nga ana e të pandehurave të lartpërmendura dhe se në mënyrë mashtruese kanë qenë vetëm në një mbledhje, dhe pas kësaj më nuk janë interesuar, por përkundrazi kanë refuzuar çdo bashkëpunim dhe pjesëmarrje mbi veprimet e organizatës ilegale.

Nga këto fakte konstatuese, gjykata nuk ka mundur të vërtetojë që në veprimet e të pandehurave Mane, Mrika e Qiqilija të ekzistojë fajet që u ngarkohet në Pretencë.

Duke marrë parasysh për këto sa u tha, gjykata të pandehurat Mane, Mrika e Qiqilija i liron nga akuza. Në bazë të të gjithave sa u parashtruan u vendos si në iapozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykuar në Gjykatën Popullore të Krahinës për Kosmet në Prizren, më datë 23 Tetor 1945.

Sekretari; M. Biqoku, kryetari; Hivzi Sylejmani

## Dokumente inkriminuese të ONDSH-së, instruksionet kryesore të komitetit qendror

Pasi se shumë të arrestuar akuzohen për shkak se kishin formuluar dhe shpërndar në komitete të rretheve shkresën "Instruksione kryesore", po e prezantojë se çfarë thuhet në të.

Pika e I. Ishte mbledhja e të gjitha shënimeve të varëve në të gjitha rrethet me komuna dhe katunde, emnin dhe biemërin, nga është personi dhe çfarë moshe kishte.

II. Ilegalistat kishin marrë për detyrë që të formonin një Këshillë të ngusht prej 6-7 vetave të cilët do të ngarkoheshin me detyra që duhet dhe mund t'i kryejn.

III. Duhet të përgatisin dhe të pranonin parulla si prej Qendrave të Komunave poashtu edhe prej fshatrave për çdo ngjarje që ka ndodhë, dhe me këto informata duhet filluar menjëherë dhe anasjelltas.

a). Asnjë detyrë apo aksion nuk duhet të bëhet nga ana e anëtarëve që veprojnë në fshatë pa djen e anëtarëve të komitetit të komunës, se ky komitet më parë duhet vu në dijeni qendrën për të dhënë pëlqimin.

b). Kurrëfarë lëvizje nuk guxon të bëhet pa urdhërat e marruna prej qendrës së rrethit, ku qendra e rrethit vazhdimisht ka me qenë në lidhje me lëvizjen që ndodhet jashtë, gjithashtu lëvizja që vepron jashtë nuk guxon të ndërmarr ndonjë aksion,

por duhet të rrijë e gatshme dhe në pritje.

c). Lajmet dhe çdo gjë tjetër duhet të vihen në dijeni që Qendrën e rrethit, në qoftëse ky qëndrim nuk mund të kryhet nga burrat për hirë të situatës së krijuar, duhet angazhuar edhe gratë të cilat janë anëtare të NDSH-së, apo të besueshme të lëvizjes.

Ç). Çdo forcë që ndodhet jashtë, në terren duhet të jetë e mvarun prej një përgjegjësi (komandanti), ku mandej prej aty mund të jenë të ndara në Toga dhe në Çeta. Gjithashtu edhe Qendra ka me qenë e lidhur drejtpërdrejt me Komanden.

Në këtë rast mund të përjashtohen rastet e jashtëzakonshme që mund t'u ndodhin togave ose qetave që nuk kanë me mujt me marrë urdhëra apo shenjën e largimit, në këtë rast ata duhet të veprojnë sipas mendimit të tyre, domethënë të rrethimit nga armiku e tjera raste. Por gjithë duke e pasur parasysh, kuptohet sipas mundësive mbas një apo dy ditësh duhet me e lajmërua qendrën se ku ndodhen. Gjithashtu çdo nevojë që kanë me pas si ushqime e të tjera duhet të kërkojnë nga komitetet komunale, aty ku ndodhen, që kështu çdo ndihmë me ju shkua duhet ditur komanda.. Rreptësisht ishte e ndaluar, se asnjë marrëveshje nuk mund të bëhej me drazhista, apo me komunistat që shtiren si drazhista, të cilët donë të hynë në radhët tona, për me e marr vesh dhe me e zbulua qëllimin e lëvizjes sonë. Dihej se pushteti ishte shumë i interesuar që të kishte të dhëna për fuqin dhe forcën e lëvizjes, ngase në një mënyrë ia kishte frikën kësaj. Në rast se bëhej ndonjë kërkes nga ana e tyre, duhet urgjentisht lajmëruar qendrën, e Qendra ka me njoftua më lartë. Qendra F. Ngarkohet për të qenë në lidhje me pikat e sipërpërmendura me G.K. e P. (Gilanin, Kaçanikun, e Prishtinën, shënim i SK-B). Prishtina duhet të hyjë në kontakt me Prizrenin, dhe poashtu duhet të hyjn në kontakt me Po e L. Pikat e mësipërme duhet të lajmërohen e të dërgohen në qendrën e

Prizrenit, dhe nga kjo qendër ka me u dërgua shifra dhe emërat që kanë me u këmbya të ngarkuemëve të besuarit e qendrave tona duhet të vihen në kontakt me përgjigjësat e Partisë komuniste, që prej tyre me mund me përfitua çdo gjë që do të jetë në favorin tonë dhe ato që mundin me qenë në damin tonë. Çdo qender duhet të bëjë një listë e të gjithë spiunëve shqiptar dhe të atyre serbë që kanë masakrua dhe masakrojnë shqiptar.

Në dokumentin që është origjinal, porse organete hetuesisë e kanë përkthyer edhe në gjuhën serbe, në origjinal nuk figuron asnjë emër, ndërsa në atë serbisht është i vendosur emëri i Tahir Dedës.

## Letra e Rifat Krasniqit, dokumenti tjetër inkriminues

Letra e cila i mveshet se e ka shkruar Rifat Krasniqi, sipas "arsyetimit" që e jep Ali Shukrija, si prokuror publik i Kosovës. Letra është e shkruar me 6 prill 1945, në Rahovec. Ajo fillon me këtë fjali: I dashtuni vëlla,

Më ka rënë për detyr që të takohem me këtë njeri, me të cilin po ta dërgoi këtë letër, dhe njëkohësisht po të lajmërojë për situatën e këtushme.

Besojë që edhe ju jeni të interesuar me shpejtësin sikurse neve. Nuk kuptojë se si deri më tash nuk kemi mujtë me bamun asgjë. Detyrë e çdo shqiptari është që të luftojë për tokën tonë shqiptare dhe për flamurin tonë, dhe për këto pika na kemi fillue me punue qysh me kohë.

Përveç që mundemi me ju lajmërua dhe me ju ditue gjerë e gjerë mbi bashk-punuasat tanë si dhe mbi organizatën tënë, por më pak fjalë po ju lajmërojm se si duhet me punue për lirinë e Kosovës sonë të robënueme nën thundrën e popullit Jugosllav.

Pika kryesore e organizatës është që te formoni Komitetin Nacional Demokratik ne çdo komunë. Në këtë komitet duhet të hyjn njerëzit më të besueshëm prej të cilëve njëri mbetet si kryetar me disa anëtar këshilltar dhe me një sekretar. Çdo kush prej komitetit të ketë lidhje dhe të lidhet me të tjerë të njohur, dhe keta përsëri të lidhen me të tjerë të besueshëm, kështu që secili prej tyre që bëjnë lidhjen nuk do të dijnë njerëzit, me të cilët janë në lidhje.

Heren e parë duhet me formue Komitetet e Rretheve me njerëz të sigurt, te cilin komitet do ta pjesëtoni ne degë-seksione si përsëmbull: të propagandës, të financave, degën e kabotazhit dhe tjera. Personat e komitetit nuk duhet me i dijt askush, vetëm anëtarët e komitetit mundin me formua shoqërin e vetë, por kjo shoqëri nuk duhet me i ditue anëtarët e komitetit.

Përpiçuni që në çdo katund të formoni komitete, por ne

kujdesin më të madhë se në qoftëse do të kaloni kufirin mundin me u diktue dhe do të bini viktima.


Propaganda për armatimin e popullit asht një nga pikat më kryesore. Sa të jetë e mundur duhet të mbledhni që të armatoset populli sa më tepër. Armet nuk është e lejueshme me ja dorëzua armikut, derisa kokën të mos e japim. Armatim bleni sa më shumë, merrni prej popullit ndihma dhe dorëzoni arkëtarit të komitetit financiar. Ndoimat me i mbledh prej njerëzve të sigurt, të cilët nuk kanë me ju diktue që janë ndihma për komitetin. Ruajuni prej kundërshtarëve tonë. Mbledhuni dhe bleni një radio me akumulator. Në qoftëse nuk na merrni vesh si duhet, atëherë na dërgoni një delegat ose dy ketu ne Komitetin e Rahovecit dhe na do iu japim udhëzime e duhuna. Te gjeni ata që nuk janë te komprometuem dhe të dyshimt, dhe që është pak më i zgjuar.

## Situata e jonë politike

Si në Rahovec ashtu edhe në Prizren, në Gjakovë dhe në çdo vend janë formue Komitetet Nacional Demokratike Shqiptare. Punët shkojnë shumë ngadalë. Lidhjet i kemi nga çdo anë e Kosovës si dhe me Shqipërin e Vjetër. Radion e kemi. Radio misioni është gati, do te fillojne bisedat me shtetet e huaja. Anglezët kanë marrë vesh për ne dhe për se shpejt në Shqipëri do të çarmatosen partizanët nga anglezët. Ushtrit e Enver Hoxhës si nga Anglezet ashtu edhe nga amerikanet nuk e kanë njoftoë as nuk e pranojn dhe do të shkatërrohet. Ne Serbi është gati kryengritja kundër Titos. Edhe na duhet të jemi gati. Politika ndërmytet Anglezve dhe amerikanëve me Ruset do te prishet, kështu që simbas lajmeve t'ardhuna prej Turkiye, keto janë ndamun, kështu që Rusija nuk ka me marrun pjesë ne San Francisko me 25 prill 1945, dhe 19 ditë do të mbahet Konferenca e Gjyqit ku do të caktohet kufijt e të gjithë popujve. Gjithashtu nuk do të jet i thirrur as Tita.

Me një fjalë të shkurtër, puna e jonë asht shumë mirë, vetëm duhet t'organizohemi dhe në kohën e caktueme te mësyem të gjithë bashku. Delegatin e juaj dërgone sa më shpejt te na, dhe këtij delegati te cilin po jua dergojmë jepni nj letër që te dijme se a është i dërguem prej jush. Emnat e juaj duhet ti ndërroni dhe të zavendsoni me sinonime si psh. Ne vend të Jusufit te thoni Fleta, në vend të Hasanit të thoni Shpata. Letrën që keni me na dergje, dergone ne emnin tim ose te kush jam unë e kush është Leka. Posten gjithashtu sa më parë të na dërgoni.

Letra përfundon me të fala të përzemërta nga Skenderbegu. Por, poashtu të fala iu dërgonte edhe Leka e Flamuri. (Vijon)



# Një përvjetor mes përvjetorësh



**Prof. dr. Hysen MATOSHI**

Kongresi i Manastirit shënon ngjarjen më të rëndësishme në historinë e kulturës shqiptare si prova e parë e një arritjeje kombëtare të kurorëzuar me sukses. Është pika kthesë në zhvillimet e përgjithshme kulturore mbarëkombëtare, por edhe një shenjë e rëndësishme e paralajmëruese për procesin e shtetformimit shqiptar. Kultura shqiptare, ndonëse kishte shënuar arritje në periudhën e Rilindjes, nëpërmjet kombëtarizimit të saj, ende zhvillohej nën ndikimin e konsiderueshëm të qarqeve të veçanta kulturore. Alfabetet e ndryshme që përdorshin nga autorët e kohës ishin shenja të divergjencave kulturore të këtyre qarqeve, ndërsa mungesa e një alfabeti unik ishte një "argument" i diplomacive fqinje për të dëshmuar se si shqiptarët na qenkëshin fise që nuk përbënin një entitet të qëndrueshëm e homogjen kombëtar.

Intelektualë të shquar shqiptarë të proveniencave të ndryshme kulturore, shoqërore e fetare, e panë si çështje të rëndësishme përzgjedhjen e një alfabeti të përbashkët, me qëllim të krijimit të një njësie unike kulturore, mbi të gjitha funksionale, kombëtare. Tridhjetë vjet pas Lidhjes së Prizrenit, elita e intelektualëve shqiptarë u mbledh në kryeqytetin e Vilajetit të atëhershëm të Manastirit me qëllim që zhvillimet kombëtare t'i vinte hullinë e mbarë të integritimit gjithëkombëtar dhe të përparimit krahas kombeve të tjera të Evropës. Marrë parasysh rrethanat e përgjithshme shoqërore, që ndërlihdeshin me

perëndimin e një Perandorie shekullore dhe në vijim edhe me apetitet pansllave për zgjerim në hapësirën etnike shqiptare, një hap i tillë ishte sfidë e madhe socio-kulturore në proceset e modernizimit të kombit.

Sfida e unifikimit të alfabetit, si kërkesë imediate e fillimit të shekullit XX bëhej edhe më e vështirë për faktin se ideologët klasikë të Rilindjes Kombëtare tashmë ishin shuar, ndërsa brezi vijues i shkrimtarëve, dijetarëve, publicistëve dhe intelektualëve shqiptarë ishte në formim e sipër. Personalitete të përmasës së De Radës dhe Naimit, në fushën e letërsisë shqipe, nuk kishte, ashtu sikundër që ende nuk kishim as ideologë të përmasës Sami Frashërit dhe Pashko Vasës, të cilët me traktatet e tyre formësuan bazat e një programi për krijimin e shtetit shqiptar.

Në rrethana të tilla kulturore, pra të mungesës së një autoriteti të gjithëpranueshëm që do të vihej në krye të alfabetizimit të shqipes - si një zgjidhje që shkrinte në një individualitetin e një gjeniu kombëtar në ardhje dhe gjenezën e tij, si pinjoll i familjes që i dha kombit tonë emra të shquar në sferën e politikës, artit dhe dijes - u shfaq Mid'hat Frashëri. Secili përvjetor i Kongresit të Manastirit na kujton në mënyrë të pashmangshme kontributin e tij prijatar dhënë përmasës, organizimit, mbarëvajtjes dhe përfundimeve të Kongresit, por na kujton gjithashtu edhe trashëgiminë e rrallë që ia ka lënë kulturës sonë në sfera të ndryshme të veprimtarisë shkencore, letrare, politike, publicistike, enciklopedike etj. Megjithatë, përvjetori i 110 i më të madhes ngjarje kulturore në historinë tonë e risjell disi më ndryshe në vëmendjen tonë Mid'hat Frashërin. Ka shumë arsye që ky përvjetor të ndërlihdet edhe më fuqishëm me emrin e tij. Dimensioni racional i kësaj ndërlihdjeje, në rend të parë, ka

të bëjë me botimin e plotë të dy kolanave të revistave të rëndësishme në historikun e publicistikës shqiptare, sikundër janë "Kalendari kombiar" dhe "Diturija", në të cilat shfaqet qoftë si themelues a drejtues, qoftë si autori identifikues i tyre dhe në rend të dytë me nismën e Institutit "Lumo Skëndo" të Tiranës që të botojë kompletin e tij të veprave të zgjedhura. Për hir të së vërtetës duhet thënë se ky kolos i letrave shqipe nuk po kthehet zëshëm vetëm me trashëgiminë e tij shkrimore e mendimore, ngase, pas një mërgimi të gjatë e të pakuptimtë, para pak ditësh, eshtrat e tij, me ceremoni të larta shtetërore, u kthyen në gjirin e Atdheut dhe ky fakt përbën dimensionin emocional të këtij viti kulturor mid'hatian. Uroj që kjo riardhje e tij në jetën tonë të pasohet edhe nga një vlerësim objektiv i historiografisë sonë, nga njohja e plotë e kontributit të tij në rrugëtimin kulturor e dituror të kombit shqiptar drejt niveleve të një shoqërie të përparuar, uroj që trashëgimia e tij shkrimore të na shërbejë edhe në këto kohë të murgëta për të gjetur rrugën e përparimit.

Kur e them këtë kam parasysh faktin se ky personalitet i shquar shqiptar, i njohur për veprimtari të gjithanshme si publicist, shkrimtar, përkthyes, albanolog, diplomat, politikan, nuk gjeti vend në Fjalorin e sapobotuar Enciklopedik të

Kosovës, ndonëse rëndësia e veprës dhe e veprimtarisë së Mid'hat Frashërit është me interes edhe për Kosovën dhe përgjithësisht viset veriake shqiptare, pastaj ai ishte edhe njohës i shkëlqyer i raporteve shqiptaro-sllave dhe, mbi të gjitha, përfaqësues i Pejës dhe firmëtar në emër të saj i Pavarësisë së Shqipërisë më 1912 në Vlorë.

Përvjetori i sivjetmë i Kongresit të Manastirit ka korresponduar me një varg përvjetorësh të rëndësishëm për historinë dhe kulturën tonë kombëtare. Në krye të herës, 2018-ta ishte shpallur nga qeveritë përkatëse të Shqipërisë dhe të Kosovës si vit i Skënderbeut, në nderim të 550-vjetorit të vdekjes së heroit kombëtar, por gjithashtu sivjet u shënuar edhe 140-vjetori i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, që shënonte të parën përpjekje për unifikim politik në rang kombëtar, me qëllim të krijimit të një strukture autonome shtetërore, pa harruar se njëkohshëm ishte edhe përvjetori i 140 i dhimbjes së madhe të zhbërjes etnike të një pjese të madhe të viseve shqiptare, të cilat, me vendimet e Kongresit të Berlinit, iu dhuruan fqinjëve. Në vazhdë të përvjetorëve nuk mund të mos e theksojmë edhe jubileun e 100-të të themelimit të Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, i cili në historikun e lëvizjes kombëtare shqiptare hyri si një organizatë

që motivoi dhe frymëzoi brezat e tërë të shqiptarëve në përpjekjet vijuese për liri, pastaj sivjet u shënuar edhe dhjetëvjetori i Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës etj.

Megjithatë, simbolika e përvjetorëve koincidon në ndërlihdjen e dy ngjarjeve të rëndësishme jubilarë, Kongresit të Manastirit si përpjekje e suksesshme e unifikimit të alfabetit të shqipes dhe Konsultës Gjuhësore të Prishtinës, e cila mbolli idenë madhore e larghedhëse në jetën e shqiptarëve të përfshirë në sintagmën "një komb - një gjuhë". Ndaj, e them me bindje se, parë në kontekstin kulturor, Kongresi i Manastirit e ka peshën e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, ndërsa Konsulta Gjuhësore e Prishtinës, e mbajtur para gjysmë shekulli, ka peshën e aktit të pavarësimin të Kosovës dhe që të dyja, si zhvillime historike, janë një kontribut vendimtar për konfirmimin e njësisë kombëtare shqiptare në Ballkan.

Këtë vështrim dua ta përfundoj me disa fjalë të kryetarit të Kongresit të Manastirit, Mit'hat Frashërit, pa asnjë dyshim aristokrat i letrave shqipe, i cili, i entuziazmuar nga arritja e parë e suksesshme kombëtare, sidomos nga fryma e saj përbashkuese, më 1909, në tekstin inicial të revistës "Diturija", të titulluar "Istori e shkrimit shqip", theksonte: "Pas kësaj nisje së lumturë, sa do që pak vonë dhe me mundim, e shohëm se gjuha jonë merr një vënt mes të gjuhëve të tjera, zë rrënjë në kompt tënë. Hovi u-dha, rruga u-çel, edhe përparimi nisi, mendimi u-hap, sa arriti në këtë ditë ku kurr gjë s'munt ta ndalojë dhe ku na duhet që të punojmë me më të madh kurajo që të fitojmë kohënë që kemi humburë gjër më sot."

Them se edhe sot, në njëqind-edhjetëvjetorin e Kongresit të Alfabetit, kemi nevojë t'i kujtojmë këto fjalë të mençura.



## Biblioteka Kombëtare e Kosovës shënoi 74-vjetorin e themelimit

PRISHTINË, 23 NËNTOR (ER) - Në ceremoninë festive të shënimit të përvjetorit të themelimit të institucionit kryesor të librit në vendin tonë kanë marrë pjesë të premtën shumë personalitete. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka thënë se është kënaqësi të festohet përvjetori i themelimit të BKK-së, duke reflektuar edhe mbi rolin e çmuar të këtij institucioni. "Është për t'u vlerësuar iniciativa që ndërmer

BKK-ja për t'u përballur me sfidat e që përkrahet vazhdimisht prej anës sonë si ministri", ka thënë ministri Gashi.

Ai ka shtuar se për t'u siguruar që bibliotekat të luajnë në mënyrë efektive rolin e tyre në zhvillimin e qytetarëve të mirë informuar përmes qasjes së lirë dhe të pakufizuar në informacion, shërbimi duhet të financohet dhe drejtohet në mënyrë adekuate nga profesionistë të trajnuar me

mbështetjen e personelit të duhur. "Vetëm nëpërmjet stafit të trajnuar profesional, mund të sigurohen standardet e përmirësuar të shkrim-leximit dhe angazhimit demokratik që janë themeli i një shoqërie të begatë të shekullit 21", ka thënë Gashi, duke shtuar se me digjitalizimin e vazhdueshëm të kulturës po bëhet një integrim më i madh i institucioneve kulturore dhe bibliotekare.



**E jashtëzakonshme**


# Policia gjen 350 mijë euro në një lavatriçe

Policia holandeze ka gjetur 350 mijë euro brenda një lavatriçeje në një shtëpi në Oeverpad në Amsterdam. Ndërsa në pranga është vendosur një 24-vjeçar me akuzën e pastrimit të parave. Policia kontrolloi banesën, ku sipas administratës komunale



nuk jetonte askush. Por gjatë kontrollit të pronës, agjentët gjetën shumën e madhe të parave të fshehura në makinën larëse.

**FOTO E DITES**



Një qytetar në Nju Jork shihet duke performuar gjatë paradës së 92-vjetorit të Ditës së Falënderimeve /AP/

**E rrallë**

# Menaxherja e Bet365 e shpërblen veten me 300 milionë euro

Shefja miliardere e firmës së basteve online, Bet365, i ka dhënë vetes një pagesë prej 300 milionë eurosh, ndërkohë që kompania raporton rritje fitimesh. Pagesa e Denise Coates llogaritet në rreth 800 mijë euro në ditë. Dhe këtë vit ajo ka dalë shumë më mirë se vitin e shkuar, kur mori 250 milionë



euro. Pasuria e familjes së saj, që përbëhet nga vëllai Xhon dhe babai Piter, është rreth 6.5 miliardë euro.

**BARSOLETA E DITËS**



Një e polic po rruhej te berberi  
-Berberi: Me falni, çka punoni ju?  
-Polic: Policit. Po ju?



**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**“ALPHA” 3D,**

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson  
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjate vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

**“JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”**

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.  
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

**“NIGHT SCHOOL”**

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.  
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

**“SIBERIA”,**

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.  
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

**“VENOM” 3D,**

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.  
Regjia: Ruben Fleischer  
Based on the Marvel Comics



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p><b>DASHI</b> Gjërat e vogla të jetës janë ato që ju mbajnë në humor dhe që ju japin energji për të përballuar çdo problem të ditës.</p>	 <p><b>DEMI</b> Një pjesëtar i familjes tuaj do të ketë nevojë për praninë tuaj sot. Anashkaloni çdo gjë tjetër për t'ju gjendur pranë.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Edhe ju mund të lodheni nga rutina e përditshme dhe doni të bëni diçka ndryshe. Kërkoni opsione që mund t'ju kënaqin.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Sot nuk do të jetë zgjidhje e mirë të lini përgjysmë një projekt të nisur. Bashkëpunëtorët tuaj do të ecin shumë përpara jush.</p>	 <p><b>LUANI</b> Këtë periudhë keni qenë shumë të impenjuar të zgjidhni çështje urgjente profesionale dhe kjo ka ndikuar për keq në humorin tuaj.</p>	 <p><b>VIRGJERESHA</b> Nuk ju mbetet shumë për t'u menduar sot, sepse çdo gjë që keni vendosur ka marrë drejtim. Ju mbetet veç të shijoni kohën.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Momentet tuaja më të mira sot do t'i kaloni në shoqërinë e miqve të mirë, por që i takoni rrallë për shkak të largësisë.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Edhe pse nuk doni të shfaqeni, sot do të jeni pjesë e rëndësishme në realizimin e një ëndrre të hershme të partnerit.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Jo gjithmonë keni qenë të aftë të fitoni besimin e personave afër jush. Për këtë arsye sot do të merrni disa kritika konstruktive.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Edhe të tjerët kanë limitet e tyre kështu që jo gjithmonë duhet të jenë në favor të zgjedhjeve dhe humorit tuaj të momentit.</p>	 <p><b>UJORI</b> Po vini në zbatim disa ide të rëndësishme, por do të hasni në pengesa nga persona që nuk ju a priste mendja se mund t'ju pengonin.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Keni vënë piketat për çështjet më të rëndësishme që do të merreni sot. Ju kanë mbetur vetëm detajet për të përcaktuar.</p>

## Kylie Jenner bën të qartë se është Mbretëresha e vitit 2019



**K**alendari vjetori i Kylie Jenner do të dalë në shitje të premtën. Dhe miliarderja më e vogël në botë zbuloi disa nga fotografitë më 119 milionë ndjekësit e saj në "Instagram". Mongolja e kozmetikës bëri të


qartë se do jetë "Mbretëresha e vitit 2019" ndërsa pozoi me një kurorë në kokë. Kylie vuri në pah format e saj bombastike me një fustan stofi ngjyrë ari ndërsa në qafë mbante një gjerdan ekstravagant me kryq.

## Ariana Grande shfaqet me unazë në gisht



**N**darja e këngëtares Ariana Grandes nga i fejuari i saj Pete Davidson, ka qenë një nga ngjarjet më të bujshme të showbizit kohët e fundit. Çifti i fejuar vite më parë, vendosën të shkëpusnin romancën e tyre disa muaj më parë.

Pas ndarjes këngëtarja e riktheu sërish tek Pete unazën e saj të diamantit, që sipas të dhënave kushtonte rreth 93 mijë dollarë. Por Ariana e ka zëvendësuar menjëherë me një të re dhe këtë herë bëhet fjalë për një tjetër lloj marrëdhënie.



## Rita Ora mahnit të gjithë me performancën e saj në Ditën e Falënderimeve

**N**ë Shtetet e Bashkuara të Amerikës është kremtuar "Dita e Falënderimeve". Kjo festë po kremtohet në një mënyrë vërtet glamuroze edhe në

Nju Jork, në qendrën e të cilit është organizuar një karnaval i madh ku pjesë e saj ka qenë edhe këngëtarja shqiptare me famë botërore, Rita Ora.

## Kush nuk do ta donte një burrë si Justin?

**M**odelja e famshme Hailey Baldwin ka festuar 22-vjetorin e lindjes. Për herë të parë në jetën e saj do të shijojë ditëlindjen si një grua e martuar. Sigurisht që dhuratat e surprizat nga partneri i saj Justin Bieber nuk do të mungojë. Një burim pranë tyre ka zbuluar surprizën që ka rezervuar ylli i popit për modelen. "Ditëlindja e Hailey përkon me festën e ditës së falënderimeve në Amerikë, kështu ata do të festojnë me familjen e modeles dhe më pas do të



nisen të dy së bashku për një udhëtim romantik", ka thënë një burim për "HollywoodLife".

## Marrëveshja për Brexit-in, Spanja i vë kusht Gjibraltarit

BRUKSEL, 23 NËNTOR - Negociatorët e Bashkimit Evropian u takuan të premten për të finalizuar projekt traktatit e tërheqjes të Britanisë nga blloku, përpara takimit të së dielës për të miratuar marrëveshjen e Brexit-it, por Spanja kërkoi garanci për të ardhmen e Gjibraltarit.

Spanja kërkon ndryshim të marrëveshjes mbi marrëdhënien e re mes BE-së dhe Britanisë si dhe një deklaratë shoqëruese ku të thuhet se e ardhmja e Gjibraltarit do të vendoset falë bisedimeve të drejtpërdrejta ndërmjet Madridit dhe Londrës. Spanja ka ende pretendime mbi

këtë territor që i është dorëzuar Britanisë në 1713.

Në një postim në Twitter kryeministri spanjoll Pedro Sanchez shkruante se Britania dhe Spanja "mbeten larg" rreth kësaj çështjeje dhe "nëse nuk ka ndryshime, Spanja do të vendosë veton ndaj Brexit-it".

Udhëheqësi britanik i Gjibraltarit Fabian Picardo kritikoi kërkesën e Spanjës për një garanci me shkrim. Ai tha se "Gjibraltari ka treguar se dëshiron në të vërtetë një angazhim të drejtpërdrejtë me Spanjën për këtë çështje".

Picardo tha për BBC-në se "Spanja është porta hyrëse fizike dhe gjeografike për Gjibraltarin

në Evropë", duke shtuar se "nuk është absolutisht e nevojshme vendosja e vetos si qëllim për ta ulur në tryezën e bisedimeve".

Spanja nuk ka fuqi të vendosë veton mbi marrëveshjen e Brexit-it, e cila nuk është e nevojshme të miratohet në mënyrë unanime, por mund të bëhet pengesë për ndonjë marrëveshje të tregtisë së lirë mes Britanisë dhe Bashkimit Evropian, gjë që do të kërkonte miratimin e të gjitha 27 vendeve anëtare të BE-së. Paketa për Brexit-in po përballet gjithashtu me një kundërshti të fortë në Parlamentin britanik, i cili duhet të votojë në favor të saj në mënyrë që marrëveshja



të hyjë në fuqi. Nëse kjo nuk ndodh Britania do të largohet nga blloku më 29 marsin e

2019-s, pa një marrëveshje për t'i zbutur shqetësimet ekonomike.

## Trumpi mund të vizitojë zonat e luftës në Afganistan

Presidenti amerikan Donald Trump duke folur me pjesëtarë të Ushtrisë amerikane nuk dha përgjigje të qartë kur u pyet nëse kishte në plan të shkonte në Afganistan. "Do të bëjmë gjëra interesante, në kohën e duhur", tha ai.

UASHINGTON, 23 NËNTOR - Presidenti Donald Trump foli me pjesëtarë të Ushtrisë amerikane për t'u uruar Festën e Falënderimeve dhe për t'u shprehur mirënjohje për shërbimin ndaj vendit. Por kur u pyet nëse do të vizitonte baza ushtarake jashtë Shteteve të Bashkuara, presidenti nuk dha një përgjigje të qartë. Të premten presidenti u takua me pjesëtarë të Rojës Bregdetare pranë rezidencës së tij të pushimeve në Florida.

Tryeza e Ditës së Falënderimeve në Shtetet e Bashkuara tradicionalisht përfshin gjelin e detit si dhe plot pjata të dyta dhe në fund një 'kek' me kungull si ëmbëlsirë. Në bazën Lake Worth pjesëtarët e Rojës Bregdetare festuan me paninë të mbushura, fruta dhe pije freskuese. Presidenti u takua me trupat dhe bëri fotografi.

Më parë, ai u telefonoi trupave amerikane me shërbim jashtë vendit.

"Vendi po ecën mirë ekonomik-

isht, më mirë se kushdo tjetër në botë. Edhe për ju duhet të jetë i mirëpritur fakti që luftoni për një vend që po funksionon mirë, për atdheun tuaj", tha ai. Tradicionalisht, presidentët amerikanë komunikojnë me ushtarë amerikanë që janë me shërbim jashtë vendit. Në disa raste ata i vizitojnë në bazat jashtë vendit, siç bëri presidenti Bush në 2003 në një vizitë të panjoftuar në Irak në Ditën e Falënderimeve. Presidenti Obama është takuar disa herë me trupat në baza të ndryshme jashtë vendit. Presidenti Trump është kritikuar se nuk ka vizituar deri tani asnjë nga kontingjentet amerikane jashtë vendit. Ai nuk dha përgjigje të qartë kur u pyet nëse kishte në plan të shkonte në Afganistan.

"Do të bëjmë gjëra interesante, në kohën e duhur", tha ai.

Një gazetar e pyeti nëse e dinte se kur mund të zhvillohej udhëtimi.

"E di, por nuk mund t'ju



them," u përgjigj presidenti. Shtetet e Bashkuara dërguan trupa në Afganistan pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit, 2001 për të dëbuar Talibanin nga pushteti. Tani Taliban po zhvillon luftë kundër Qeverisë afgane që mbështetet nga Shtetet e Bashkuara. Një i dër-

guar i Uashingtonit ka hapur një dialog të drejtpërdrejtë me Talibanin.

"Jemi aktualisht në vazhden e negociatave të forta në Afganistan. Shumë njerëz nuk e dinë këtë," tha presidenti. Por Trumpi pohoi se bisedimet mund të mos japin rezultat.

"Nuk e di nëse do të jenë të suksesshme, ndoshta jo. Nuk i dihet. Ndoshta do të kenë sukses, ndoshta jo", tha ai.

Misioni ushtarak në Afganistan u ka kushtuar Shteteve të Bashkuara afro 1 trilion dollarë dhe humbjen e 2400 ushtarëve amerikanë.

## Orban: Gruevski është aleat i popullit hungarez

BUDAPEST, 23 NËNTOR - "Pa ish-kryeministrin maqedonas, do ta kishim shumë të rëndë që t'i mbrohim kufijtë e Hungarisë nga vala a refugjatëve pavarësisht asaj që ne ndërtoam një mur. Ai edhe atëherë kërkoi ndihmë dhe ne i ndihmuam", tha kryeministri Viktor Orban, duke shtuar se Gruevski nuk është vetëm aleat i tij, por aleat i gjithë popullit hungarez.

"Njeriu duhet sinqerisht t'i trajtojë aleatët e tij", tha Orban duke mos dashur të zbulojë se me

çfarë dokumenti ka hyrë në Hungari Gruevski.

Gjatë kohës së emisionit, i pari i Qeverisë hungareze theksoi se në 30-vjetorin e demokracisë së Hungarisë, kjo nuk është hera e parë që shteti ka pranuar njerëz të rëndësishëm, por tha se asnjë prej tyre nuk ka qenë në cilësinë e Gruevskit, duke përsëritur qëndrimin e tij se ai është ish-kryeministër i një shteti të rëndësishëm në korridorin e migracionit drejt Hungarisë.

Orbani tha se pas ndjekjes së

ish-kryeministrin maqedonas, qartazi kanë qëndruar organizatat e Xhorxh Soros, i cili, siç tha, vazhdimisht i ka ndjekur gjurmët e Gruevskit.

Në lidhje me sjelljet e ish-kryeministrin Gruevski në Maqedoni, Orbani tha se Hungaria e ka të patjetërsueshme që qëndrojnë larg këtyre, por edhe se nuk do të lejojë shkelje të ligjit, por vetëm gjykim të drejtë.

"Ekzistojnë beteja të komplikuar", tha Orbani, duke shtuar se të gjitha janë pjesë të drejtësisë.





# Ermonela Jaho për “The Telegraf”: Shpirti im është i zhveshur kur këndoj

Si një vajzë e re që po rritej pas Perdes së Hekurt të diktaturës, ekspozimi i sopranos shqiptare Ermonela Jaho në opera ishte i kufizuar. Por kur ishte 13 vjeç, vëllai i saj e mori për të parë La traviata në gjuhën shqipe dhe shpirti i saj filloi të fluturojë.

“Gjithçka ishte aq e mbyllur në vendin tim komunist sa që mund të nderohe në botë brenda vetës. Dëgjimi i kësaj muzike më bëri të kuptoj se mund të udhëtoja në mendjen time. Fillova të shihja mundësi të reja.”

Në të vërtetë, roli i kurtizanes Violetta në La traviata ka qenë një prezencë e vazhdueshme në karrierën e Jaho-s. Ajo ka kënduar pjesë në të gjithë botën, duke u krahasuar me Maria Callas gjatë karrierës së saj. Jaho ndihet gjithmonë aq energjike në performancat e saj. The Economist e përshkruan atë si “sopranoja më e famshme në botë” dhe aftësitë e saj

këngëtare e operës.

“Ajo ishte një grua tepër e fortë, por unë gjithmonë mund të shoh dhimbjen dhe keqardhjen në fytyrën e saj”, thotë Ermonela për nënën e saj. “Ajo ishte e lumtur për mua, por kurrë nuk kishte guximin të më shihte në skenë”. Jaho i shkroi asaj për ta pyetur se pse kishte frikë, por ajo vdiq para se letra të dërgohej.

Këngëtarja thotë se jeta nën komunizmin gjithashtu kishte një ndikim në prirjen e saj “të ndjeshme”.

“Kur je fëmijë, duhet të shohësh gjëra të mrekullueshme, jeta jote duhet të jetë e mbushur me flutura”, thotë ajo. “Pashë



në Mantova dhe më pas në Romë, duke fituar konkurse të ndryshme dhe duke ndërtuar një repertor të guximshëm dhe të pasur. Që në fillimi, ajo e dinte se a duhej të gjente zërin e saj kur erdhi në interpretime – si natyrisht Violetta, por gjithash-

tu Manon, Mimi dhe Sër Angelica.

“Isha kaq e frikësuar kur fillova sepse kritikët gjithmonë ju krahasojnë me dikë tjetër. Sapo kuptova se ishte një çështje shije dhe jo të gjithë do t’ju pëlqente, unë u bëra e sigurt në vetvete. E dija që duhej t’i jepja [audiencës] diçka njerëzore. Kjo është ajo që ata duan. Unë nuk mendoj se publiku dëshiron përsosmëri.”

Më datë 21 nëntor Jaho ishte në Sallën e Festivalit Mbretëror, ku luajti veprën e parë të Puccinit, melodramën e mbinatyreshme Le Villi, në formën e tij origjinale dhe bashkëpunoi me Orkestrën Filarmonike të Londrës. Jaho thotë, në disa mënyra që ishte një punë e papjekur. “Ju mund të shihni se Puccini ende po përpiqet të gjejë rrugën e tij, por gjithashtu mund të shihni se çfarë do të bëhet – mënyra në të cilën ai nuk lundron ndjenjat e tij, mënyrën në të cilën ai ndan drejtë emocionet”.

Siç është zakoni, axhenda e Jahos është e plotë deri në vitin 2022

dhe përfshin rolin e titullit në Anna Bolena të Donizetti në vitin e ardhshëm në Shtëpinë e Operës së Sidneit. Kur nuk punon, Jaho jeton në Nju Jork me bashkëshortin e saj Ervin Stafa.

“Është shumë e vështirë, sepse ne gjithmonë udhëtojmë, por dashuria për njëri-tjetrin është kaq e rrënjësor sa që nuk ka rëndësi.” Ajo pushon. “Dhe e di se e gjithë kjo nuk do të zgjasë përgjithmonë.”

E pyes nëse ajo shqetësohet për moshën, për rënien e mundshme të roleve yllore. “Kam merak aq shumë dhe më vjen turp të them këtë. E di që kjo tingëllon egoiste, por nuk dua që kjo të ndalet. Kur kam luajtur Antonia [në Les contes d’Hoffmann] kohët e fundit, isha në veshjen e kësaj vajze dhe më bëri të mendoj se sa me fat kam qenë në karrierën time të hershme. “Por ne të gjithë jemi të pasigurt. Pa marrë parasysh se sa e mirë je, ne jemi gjithmonë një fëmijë i vogël brenda vetes.”

**Përkthyer nga gazeta Shqip Online**



teknike, të dëshmuara nga një zë i pasur – e kanë bërë të pakapërcyeshme për shumicën e kritikëve. Ka edhe pasionin e saj absolut që, thotë ajo, shkon krahas për krahas me muzikën.

“Çdo shënim, çdo tingull që bëj është si një copë emocioni nga zemra. Është sikur shpirti im është lakuriq kur këndoj dhe nuk mund të fshihem. Është duke u ekspozuar, por edhe terapi në një mënyrë.”

Fjalët e “zemër” dhe “shpirt” shfaqen shumë në bisedën e Jahos dhe ajo thotë se ka një melankoli të rrënjësor thellë. Pjesërisht kjo rrjedh nga marrëdhënia e ndërlukuar që a kishte me nënën e saj të ndjerë që kishte ambicie të porealizuara në jetë gjithashtu si një

realitete të caktuara që nuk doja të shihja dhe kjo më bëri të pakënaqur. Por tani mendoj se mund të ketë qenë për tmirë. Çdo përvojë dramatike e ka ndihmuar artin tim “.

Më 19, pasi fitoi një konkurs në Shqipëri, ajo shkoi për të studiuar në Itali, së pari në Mantova dhe më pas në Romë, duke fituar konkurse të ndryshme dhe duke ndërtuar një repertor të guximshëm të pasur në Verdi dhe Puccini. Që nga fillimi, ajo e dinte se ajo duhej të gjente zërin e saj kur ajo erdhi në interpretime – natyrisht Violetta, por gjithashtu Manon, Mimi dhe Sër Angelica.

Kur ishte 19 vjeçe, pasi fitoi një konkurs në Shqipëri, ajo shkoi për të studiuar në Itali, së pari



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

FULHAM - SOUTHAMPTON

2

TOTTENHAM - CHELSEA

GG

SHEFF WED - DERBY

2

# Feronikeli me fitore ndaj Dritës synon të bëhet lider

Kastriot Rexha ka konfirmuar se Feronikeli do të luajë ndaj Dritës për ta fituar ndeshjen, pasi tri pikët do ta rikthenin këtë skuadër në pozitën e parë në IPKO Superligë. "Do të jetë një ndeshje interesante për faktin se të dyja skuadrat kanë futbollistë cilësorë dhe kanë synime të mëdha në këtë edicion. Ne jemi në garë për pozitën e parë, prandaj shkojmë në Gjilan për ta marrë maksimumin e pikëve", ka thënë Rexha. Ndërsa mesfushori Endrit Krasniqi ka paralajmëruar se edhe Drita kërkon fitore



**EPOKA E RE**

**Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 23 NËNTOR** - KF Feronikeli në Gjilan synon ta marrë maksimumin e pikëve ndaj kampiones aktuale të elitës, KF Drita, dhe në këtë mënyrë të rikthehet në pozitën e parë në IPKO Superligë. Në fakt, Prishtina barazoi me Ferizajin dhe një fitore eventuale në derbin e së dielës do ta rikthente "Niklin" në pozitën e parë. Ish-sulmuesi i skuadrës së Dritës dhe tash i Feronikelit, Kastriot Rexha, ka thënë të premten për "Epokën e re" se të dielën do të jetë një derbi i vërtetë, pasi kualiteti i të dyja skuadrave është i madh. "Do të jetë një ndeshje interesante për faktin se të dyja skuadrat kanë futbollistë cilësorë dhe kanë synime të mëdha në këtë edicion. Ne jemi në garë për pozitën e parë, prandaj shkojmë në Gjilan për ta marrë maksimumin e pikëve. Në aspektin personal është një ndeshje e veçantë, pasi kam luajtur dhe kam pasur suksese me Dritën, por ne jemi profesionistë dhe gjithçka është normale", ka thënë Rexha, i cili vlerësohet ndër lojtarët më meritore për suksesin e skuadrës gjilnase në rrugëtimin drejt titullit kampion. Për ndeshjen që zhvillohet të dielën në kuadër të xhiros së 16 foli edhe mesfushori i Dritës, Endrit Krasniqi. Ky i fun-

dit beson se skuadra e tij do ta arrijë fitoren dhe ta shkurtojë diferencën e pikëve me Feronikelin dhe Prishtinën. "Kemi pasur kohë për përgatitje dhe jemi të gatshëm për ndeshjen derbi ndaj Feronikelit. Presioni është te Feronikeli, skuadër e cila duhet gjithsesi të fitojë për të mbetur në hap me Prishtinën, kurse edhe ne kemi synimet tona që të mbesim në hap me skuadrat e para në tabelë. Shpresojmë se do ta arrimë fitoren, pa harruar se kundërshtari ka ekip cilësor", ka deklaruar Krasniqi. Ndërsa sot (e shtunë) zhvillohen tri ndeshje të tjera të kësaj xhiroje: Flamurtari - Llapi, Ballkani - Gjilani dhe KEK-u - Liria.

## Ferizaj sërish ndal Prishtinën, Drenica u rikthehet fitoreve

KF Ferizaj sërish e ka ndalur skuadrën e Prishtinës, pasi ndeshja e zhvilluar të premten në kuadër të javës së 16 u mbyll me rezultat 0-0. Ferizaj ia ka arritur që për herë të dytë brenda këtij kampionati ta ndalë Prishtinën, pasi edhe ndeshja e zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë kishte përfunduar 0-0. Prishtina vazhdon të jetë e para në renditjen tabelore me 37 pikë, por në rast të fitores së Feronikelit, kryeqytetasit do të zbrisnin në

pozitën e dytë në tabelë. Ferizaj renditet në pozitën e parafundit me 15 pikë. Në ndeshjen tjetër fitorja i ka takuar skuadrës së Drenicës, e cila, pas disa ndeshjeve, ka arritur t'i arketojë pikët e plota. Kuqezinjtë e mposhtën Trepçën '89 me rezultat 3-0 në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj. Në minutën e 15-të Arsen Sykaj realizoi për rezultatin 1-0. Në pjesën e dytë kuqezinjtë realizuan edhe dy gola të tjerë nëpërmjet Pasomas (49) dhe Musës (90). Mysafirët nga Mitrovica u munduan të rikthehen në lojë, por nuk arritën të realizojnë asnjë gol dhe ndeshja u mbyll me rezultat 3-0. Pas kësaj ndeshje, Drenica renditet në pozitën e shtatë me 21 pikë, ndërsa '89-shi bie një pozitë më poshtë me 19 pikë.

## IPKO Superliga

**Drenica - Trepça '89** 3-0  
**Ferizaj - Prishtina** 0-0

**Të shtunën takohen:**  
**Flamurtari - Llapi**  
**Ballkani - Gjilani**  
**KEK-u - Liria**

**Të dielën takohen:**  
**Drita - Feronikeli**

## SHKURT

### Sot fillon turneu i 20 "Adem Jashari"

Palestra "Minatori" në Mitrovicë këtë fundjavë do të jetë arenë e edicionit jubilar, të 20-tit me radhë, të turneut ndërkombëtar në boks "Adem Jashari". Të shtunën dhe të dielën Federata e Boksit e Kosovës (FBoxK) do ta organizojë turneun në të cilin është konfirmuar pjesëmarrja e 10 shteteve. Këshilli organizativ, në krye me kryetarin e FBoxK-së, Ramadan Selimi, ka thënë se, pavarësisht prej vështirësive që kanë pasur, kanë arritur t'i bëjnë përgatitjet e duhura për ta organizuar turneun në mënyrën më të mirë. Hapja ceremoniale do të jetë në program të shtunën në orën 15:45, ndërsa gjysmëfinalet në orën 16:00. Finalet e këtij turneu do të mbahen të dielën nga ora 16:00.

### U19-shet e Kosovës mësojnë kundërshtarët për Kampionatin Evropian

Në Nyon të Zvicrës është hedhur shorti për kualifikimet e Kampionatit Evropian 2019/2020 për femra për grupmoshën 19 vjeçe. Federata e Futbollit e Kosovës u përfaqësua nga Vjollcë Krasniqi, anëtare e KE dhe kryetare e Komisionit për Futbollin e Femrave dhe Valbonë Gashi, menaxhere e futbollit të femrave. Kosova u përfshi në grupin e 12 dhe do ta zhvillojë ndeshjen në rrethin e parë kualifikues me Turqinë, Danimarkën dhe Hungarinë. Garat e këtij rrethi do të zhvillohen prej 2 deri më 8 tetor të vitit 2019 në Turqi.

### Përballja Penza - Bashkimi vendos kampionin vjeshtor

Xhiroja e tetë në Ligën e Femrave do ta sjellë derbin ndërmjet dy ekipeve deri më tani të pamposhtura në elitën e basketbollit të Kosovës. Penza është nikoqire e Bashkimit në duelin që do të luhet të shtunën me fillim nga ora 17:00 në palestrën "Karagaçi" në Pejë. Bashkimi është lider në renditjen tabelore, ku nga 7 ndeshje ka regjistruar po aq fitore, derisa Penza nga 6 ndeshje ka realizuar po aq fitore dhe ka grumbulluar 12 pikë. Përballja në mes të këtyre dy skuadrave pritet të sjellë rivalitet të madh në parket, ndërsa ai ekip që shënon fitore në këtë takim do të shpallet kampion vjeshtor, një xhiro pa përfunduar stinori vjeshtor.

## Cana: Heskey, kundërshtari më i vështirë në Angli

TIRANË, 23 NËNTOR - Ish-kapiteni i Kombëtares së Shqipërisë dhe skuadrës së Sunderlandit, Lorik Cana, ka folur për kohën kur ishte pjesë e Premierë Ligës. Futbollisti shqiptar është përballur me shumë yje gjatë

kohës kur ishte pjesë e Sunderlandit, por e ka vlerësuar si më të vështirin Emile Heskeyn. "Të tregohem i singqertë, kur isha në formë, në aspektin fizik nuk kisha kundërshtarë superiorë. Më pas pata një problem në gju

dhe skuadra vuajti gjatë janarit. U vura përballë disa lojtarëve të mëdhenj, si Lampard dhe Gerrard por, të jem i singqertë, kundërshtari më i fortë me të cilin kam hequr keq, madje dhe në aspektin fizik, ka qenë Emile

Heskey. Ai ishte jashtëzakonisht i fortë, i tmerrshëm. Mora karton të kuq atë natë, për dy kartonë të verdhë, u mundova ta shtyja Heskeyn dhe e pata të pamundur, ishte shumë i fuqishëm", ka thënë Cana.



## Allegri: Ronaldo e meriton 'Topin e Artë'

TORINO, 23 NËNTOR - Trajneri i Juventusit, Massimiliano Allegri, mendon se Cristiano Ronaldo e meriton çmimin e "Topit të Artë". "Nuk e di se kush do të jenë finalistët për 'Topin e Artë', por Ronaldo e meriton pa më të voglin dyshim", ka thënë Allegri, duke shtuar se transferimi i Cristiano Ronaldos te "Zonja e Vjetër" e ka rritur konkurrencën në stërvitje. "Ronaldo dhe Mario Mandzukic ndihen mirë bashkë. Edhe kur luajnë të dy bashkë me Dybala, përsëri kanë harmoi. Ronaldo ka rritur konkurrencën në stërvitje", ka thënë Allegri. Lidhur me ndeshjen e radhës kundër SPAL-it, Allegri ka deklaruar: "Sa i përket takimit me SPAL-in, Peri do të jetë titullar, ndërkohë besoj se Matuidi do të qëndrojë pushim dhe Dybala do ta nisë nga stoli. Është e sigurt se Cristiano dhe Mandzukic do të jenë titullarë". Skuadra e Juventusit është e para në Serinë A, kurse synimi i saj është triumfi në të gjitha garat.



## PSG-ja ruan Neymarin dhe Mbappen për Ligën e Kampionëve

PARIS, 23 NËNTOR - Me fushatën për titullin në Francë që është në rrugën e duhur, Paris SG nuk do të rrezikojë ta përkeqësojë gjendjen fizike të dy prej futbollistëve kryesorë, duke i kursyer në fundjavë. Braziliانى Neymar dhe kampioni i botës Kylian Mbappe nuk do të luajnë të shtunën, në impenjimin që parashikon Liga 1, për shkak të një ndeshjeje më të rëndësishme kundër Liverpoolit.

Trajneri Thomas Tuchel parashikoi mungesën e tyre duke fokusuar gjithçka në Ligën e Kampionëve. "Nuk janë në gjendje të rëndë, por nuk do të rrezikojmë me Neymarin dhe Mbappen", ka thënë tekniku i parizienëve. Praktikisht të shtunën, dy sulmuesit që "mbjellin" panik në prapavijat e kundërshtarëve në thuasje çdo ndeshje, nuk do të jenë në javën e 14 të kampionatit francez ndaj Toulouses. Ideja për t'i dhënë më tepër kohë rikuperimit të



tyre u ndikua nga stafi mjekësor. Ndërkohë, Paris SG duhet ta riformatojë repartin ofensiv në sfidën e afërt. "Pa këta dy sulmues ndryshon gjithçka, por

nuk është hera e parë. Kemi gjetur zgjidhje edhe në të kaluarën, sepse kemi futbollistë të mëdhenj që duhet të tregojnë se janë gati", ka deklaruar Tuchel.

### SHKURT

#### Liverpooli 'blindon' Manen

Ylli i futbollit senegalez Sadio Mane ka nënshkruar kontratë të re me Liverpoolin, e cila do ta mbajë atë në "Anfield Road" deri më 2023. 26-vjeçari iu bashkua Liverpoolit në vitin 2016 nga Southamptoni dhe deri tash ka realizuar 40 gola në 89 paraqitje. Në të kaluarën Mane ka luajtur edhe për Salzburgun dhe Metz-in, kurse për kombëtaren e Senegalit është paraqitur në 58 ndeshje.

#### Dortmundi kompletton transferimin e Alcacerit

Borussia Dortmundi e ka kompletuar transferimin e Paco Alcacer nga Barcelona. 'Milionerët' gjermanë përmes një komunikate kanë njoftuar se kanë përdoruar të drejtën e blerjes së plotë të sulmuesit spanjoll nga skuadra spanjolle. Alcacer, pas një periudhe dëshpëruese te Barça, verën e kaluar iu bashkua Dortmundit në formulën e huazimit, për ta kompletuar të premtën transferimin. Ish-sulmuesi i Valencas që ka shënuar nëntë gola këtë sezon ka nënshkruar kontratë me Dortmundin deri në vitin 2023.

#### Alonso: Rikthehem vetëm nëse ndihem i dëshpëruar

Gara e Abu Dhabi do të jetë e fundit në Formula 1 për Fernando Alonso, dy herë kampionin e botës, që ka vendosur të mos garojë më në pistat e Formula 1. Spanjollit ka deklaruar me kohë largimin nga McLaren në fund të këtij sezoni. "Dera me Formulën 1 nuk është e mbyllur plotësisht, pasi nuk e di se si do të ndihem vitin tjetër. Ndoshta, nëse do të jem i dëshpëruar në divan, do të rikthehem. Gjithçka do të varet nga unë. Nëse do të rikthehem, do të jetë një motiv personal", ka thënë Alonso. Më tej, pilot spanjoll ka shtuar: "E di që të dielën në pistë do të kem emocione. Kam 15 vjet në Formulën 1 dhe kam kaluar shumë emocione, momente të bukura dhe më pak të bukura. Kujtimet më të mira i kam me njerëzit që kam njohur në këto vite, me të cilët kam punuar. Kujtoj gjithçka, gara, aksidente, strategji gare, mekanikë, kolegë etj. Unë kam dhënë gjithnjë maksimumin në pistë, duke u përpjekur t'i ndihmoj të rinjtë dhe argëtoj fansat".

#### Tottenhami nuk mendon ta shesë Eriksenin

Pas interesimit të shumë skuadrave të mëdha evropiane për mesfushorin Christian Eriksen, Tottenham Hotspur ka filluar ta mendojë gjetjen e mundësinë së vazhdimin të kontratës. Këtë lajm e ka konfirmuar trajneri Mauricio Pochettino. "Pavarësisht prej ofertave nga ekipet e tjera, klubi po punon për ta marrë vendimin e duhur", ka thënë Pochettino, i cili ka shtuar se edhe Erikseni ka kërkuar kohë për ta marrë vendimin e duhur për të ardhmen e tij.

#### Bayerni ende nuk ka vendosur për Jamesin

Bayern Munchen ende nuk ka vendosur për të ardhmen e James Rodriguezit. Lajmin e ka konfirmuar presidenti i Bayern Munchenit, Karl-Heinz Rummenigge, i cili ka bërë me dije se për të ardhmen e lojtarit të huazuar nga Real Madridi vendimi do të merret në muajt e ardhshëm. "Kemi një marrëveshje, ku ekziston një opsion që mund ta ushtrojmë deri më 15 qershor 2019. Jemi në nëntor, nuk ka kuptim të flasim që tani për këtë çështje. Do të vendosim në momentin e duhur, por me siguri jo më të ardhmen e afërt. Nuk ka pse të nxitohemi, duke parë klauzolën që kemi në kontratën e huazimit të tij nga Realit", ka thënë Rummenigge.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government  
Ministria e Administratës Publike – Ministarstvo Javne Administracije  
Ministry of Public Administration

Duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës L. Nr. 03/L - 149 dhe Rregulloren Nr. 02/2011 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës :

## KONKURS

**Titulli i punës :** Zyrtar i Lartë për Menaxhimin e Mirëmbajtjes së Sistemeve- (1 vende pune)

Nr.ref.- RN00004069/ MAP-DSPIMNQ

Kategoria funksionale : Niveli Profesional

Koeficienti : 8

Lloji i pozitës : Karrierës

Orët e punës : 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Pa afat të caktuar

Vendi i punës : Prishtinë, Ndërtesa "ish Rilindja"

### Qëllimi i vendit të punës :

Planifikimi, organizimi, kontrolla dhe realizimi i menaxhimit të sistemeve dhe pajisjeve të hidroteknike në ndërtesat qeveritare .

**Nëpunësi raporton te :** Udhëheqës i Divizionit të Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Të menaxhojë, mbikqyrë, kontrolloj realizimin e planeve të aprovuara të mirëmbajtjes për pajisjet të hidroteknike në ndërtesat qeveritare ;
2. Të koordinoj dhe ngrit nivelin e bashkëpunimit dhe profesionalizmin në kryerjen e aktiviteteve të njësive dhe më gjërë,
3. Të menaxhon, kontrolloj dhe mbikqyrë realizimin e obligimeve për kryerje të shërbimeve, liferime të mallrave të ndryshme, azhurimin e shënimeve në mënyrë periodike;
4. Të aplikoj udhëzimet administrative, udhëzimet e pajisjeve, procedurave, rregullave dhe ligjeve Teknike për të mundësuar menaxhimin e suksesshëm të sistemeve Hidroteknike në ndërtesat qeveritare duke i harmonizuar me Ligjin për punën dhe Ligjin për shërbyes civil;
5. Të përpilojë raporte periodike dhe sipas kërkesave;
6. Te bej menaxhimin e projekteve hidroteknike ;
7. Të kryej ndonjë detyrë tjetër sipas kërkesës nga mbikëqyrësi.

### Shkathtësitë e kërkuara:

- Fakulteti teknik drejtimi : Inxh i Hidroteknike- Bachelor;
- Së paku 3 vite përvojë pune profesionale;
- Përvojë dhe aftësi të mira në planifikimin e menaxhimit të mirëmbajtjes të sistemeve dhe pajisjeve të hidroteknike;
- Njohuri të mirë pune me kompjuter ( Word, Excel, Internet, Auto Cad ;
- Njohuri për implementimin e sistemeve të BMS për menaxhimin e ndërtesave ;
- Aftësi të mira komunikuese më gojë dhe me shkrim të gjuhës shqipe, e dëshërueshme e gjuhës angleze dhe serbokroate;
- Aftësi për punë në ekip, dhe përmëshje të detyrave dhe punëve të vështira;

Ministria e Administratës Publike mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.

### Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, të kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit në ueb faqen e MAP-it dhe shtypin ditor. Formularët për aplikim mund të merren në receptionin e MAP-it, zyrën nr.320 kati i III-të ose mund të tërhiqen nga ueb faqja e MAP-it në adresën <http://map.rks-gov.net/> dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore në adresën: Ndërtesa e ish Rilindjes kati i III-të nr. zyrës 320 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 8:00 – 16:00. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/200 30 552.

**Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten:** Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit. Datat e mbajtjes së intervistave për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me këtë konkurs, do të publikohen vetëm në ueb faqen zyrtare të Ministrisë së Administratës Publike.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government  
Ministria e Administratës Publike – Ministarstvo Javne Administracije  
Ministry of Public Administration

Na osnovu Zakona o Državnoj Službi Kosova L.Br. 03/L - 149 i Uredba Br. 02/2011 god.o Postupcima Rekrutovanja u Civilnoj Službi Republike Kosovo:

## KONKURS

**Naziv rada:** Visoki Zvaničnik za Menadžiranje i Održavanje Sistema (1 radno mesto )  
Br.ref. RN00004069/ MAP-DSPIMNQ

Funkcionalna kategorija: Profesionalni Nivo

Koeficienti : 8

Vrsta pozicije: Karijera

Radne časove: 40 sati nedeljno

Trajanje imenovanje: Trajno

Radnog mesto: Priština, Zgrada "bivša Rilindja"

### Cilj radnog mesta:

Planiranje, Organizovanje, kontrola i realizaciju menadžiranja Hidrotehničkim sistemima i opremom u državnim zgradama.

Zvaničnik izveštava kod: Rukovodilaca Sektora za Menadžiranje Zgrade Vlade

### Zadaci i odgovornosti :

1. Da menadžira, nadgleda, kontroliše realizaciju i odobravanje planova održavanja hidrotehničke opreme u vladinim zgradama;
2. Da koordinira i povća nivo saradnje i profesionalizma u sprovođenju jediničnih aktivnosti i šire;
3. Da menadžera kontroliše, i nadgleda realizaciju obaveza za objavljivanje usluge, isporuke različitih roba, ažuriranje periodično beleške ;
4. Primenjuje administrativno uputstvo, uputstva za opremu, procedure, pravila i tehničke zakone kako bi se omogućilo uspešno upravljanje hidrotehničkim sistemima u državnim zgradama usklađivanje sa zakonom o radu i zakon o civilnim službenicima ;
5. Da sastavlja periodične izveštaji i prema zahtevima;
6. Da menadžira hidrotehničkim projektima;
7. Da završava bilo koji zadatak po zahtevu nadzornika.

### Potrebne veštine :

- Tehnički fakultet smer: Inženjer hidroelektričnog bachelora
- Najmanje 3 godine profesionalnog iskustva,
- Iskustvo i dobre veštine u planiranju sistema upravljanja održavanjem i hidrotehničku opremu.
- Dobro poznavanje kompjutera (Word, Exel, Internet, AutoCad
- Poznavanje implementacije BMS sistema za upravljanje zgrade
- Dobre usmene i pismene komunikacijske veštine na albanskom, poželjnom engleskom i srpsko-hrvatski jezik.
- Sposobnosti za rad u ekipe i ispunjavanje teških radnih zadataka.

Ministarstvo Javne Uprave dočekuje prijave svih muških i ženskih osoba iz svih zajednica

### Uslovi učesnika konkursa :

Pravo aplicirani imaju svih građani Republike Kosova koji imaju puno pravnu sposobnost za delovanje civilnih i političkih prava , i ima potrebnu profesionalnu edukativna priprema i sposobnost za obavljanje dužnost , i koji imaju fizičke sposobnosti, potrebni za određenu poziciju .Datum zatvaranje konkursa : Konkurs je otvoren 15 kalendariskih dana od dana objavljivanja na veb sajt MJU- vi i dnevnoj štampi .Podnošenje zahteva : Prijave za aplicirani mogu dobiti na recepciji MJU- vi, Kancelarija br,320 III- sprat ili u veb sajt MJU- vi u adresu <http://map.rks-gov.net/> i dostavljaju u Diviziju Ljudske Resurse na adresu: Dom štampe Rilindja III- sprat Br. Kancelarije 320 – Priština ,svakog radnog dana od 8:00 –16:00.časova .

Za detaljnije informacije možete kontaktirati na br. Tel. 038/200 30 552.

**Uz aplikaciju treba priložiti :** Kopiju lične karte, kopija kvalifikacione dokumentacije , kao i druga potrebna dokumenta prema konkursu .Datum održavanje intervjuja za kandidate koji ispunjavaju uslove predviđene u ovom konkursu , bi će objavljen samo u službenom veb sajt Ministarstvo Javne Uprave .



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo/ Republic of Kosovo**  
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council  
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat

Në bazë të nenit 10 dhe 11 lidhur me nenin 14A të Ligjit Nr. 05/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

**KONKURS**

**Referent i Lartë në Prokurorinë Themelore në Gjilan**

REFERENCA	Kodi: SKPK/PTH/ POZ - 009
Emri Pozitës:	<b>Referent i Lartë</b>
Pozita:	Pozitë e karrierës
Niveli:	Profesional 2
Kodi punës:	DR/ 850 DU+2
Grada punës:	9
Numri i Pozitave:	Një (1) pozitë
Raporton tek:	Administratori
Koeficienti:	Shtatë (7)
Akti i cmërimit:	Pa Afat
Puna provuese:	12 muaj
Vendi:	Gjilan

**Qëllimi i vendit të punës:**

Ofron përkrahje të gjerë administrative dhe teknike lidhur me lëndët e pranuar në njësinë organizative ku është punësuar, mban evidenca të sakta dhe me kohë në regjistrin e regjistrimit të lëndëve dhe regjistrin e çregjistrimit të lëndëve sipas kërkesave të specifikuar të vetë regjistrin, kujdesi për lëndët dhe shkresat e lëndëve.

**Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:**

Regjistron me kohë lëndët në regjistrin e pranimit të lëndëve me të gjitha të dhënat që kërkohen sipas regjistrin duke mbajtur evidenca të sakta të lëndëve dhe shkresave të lëndës duke e mbajtur edhe evidencën elektronikë;

Çregjistron lëndët dhe mban evidenca të sakta në regjistrin përkatës dhe në mënyrë elektronike, mban evidenca për lëndë specifike dhe të rëndësishme të veçantë, duke vepruar me vetë-iniciativë dhe pa mbikëqyrje të drejtpërdrejtë.

Përgjegjës për afate dhe saktësi të punës;

Mbikëqyrë sistemin e përcjelljes së lëndëve dhe menaxhon me lëndët sipas punës së ngarkuar;

Kontrollon lëndët dhe lëvizjen e tyre brenda institucionit, duke qenë në gjendje që në çdo kohë ta sigurojë lëndën për përfaqësim në Gjykatë;

Mban evidenca të sakta e të plota lidhur me dosjet dhe shkresat e lëndëve, akteve, shkresave dhe dokumenteve tjera zyrtare, përfshirë edhe përgatitjen e raporteve për punën e kryer në periudha të caktuara raportuese;

I gatshëm për kryerjen e çdo detyre tjetër si referent në shkrimore në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale;

Kryen edhe punë tjera të lidhura me punën e referentit, të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

**Njohuritë,shkathësitë aftësitë për vendin e punës:**

Shkathësi të mirë komunikimi me shkrim dhe me gojë,

Aftësi të rregullimit dhe të ruajtjes së kujdeshme të dosjes së lëndëve dhe shkresave,

Aftësi të punojë e pavarur dhe në mënyrë ekipore,

Shkathësi të mira të punës me kompjuter (Word dhe Excel).

**Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:**

Diplomë Universitare, Fakulteti Juridik, Shkenca Sociale, Administratë Publike.

**Përvoja e Punës:**

Së paku dy vite përvojë pune profesionale.

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit në faqet zyrtare të Prokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, si dhe në gazetën ditore, duke filluar nga data 23.11.2018 deri me datë 07.12.2018 si datë e mbylljes së konkursit.

**Paraqitja e kërkesave:** Formulari për aplikim mund të merret në receptionin e ndërtesës së Prokurorit të Shtetit adresa: Rruga: "Luan Haradinaj" p.n. apo mund të printohen nga <http://www.kpk-rks.org/> apo <http://www.psh-ks.net/>.

**Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00,** në Divizionin e Burimeve Njerëzore, kati VII, Zyra Nr. 702, Prishtinë, Kosovë;

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038 / 200 18874 prej orës 08:00 – 16:00.

**Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës."

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit të kërkuar:

- 1.Dëshminë e kualifikimit shkollor;
- 2.Dëshmi mbi përvojën e punës, *Vërtetimi ose kontrata e punës.*
- 3.Dy rekomandime (nëse keni);
- 4.Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla);
- 5.Dokumentin e identifikimit-letërnjoftimi i fotokopjuar;
- 6.Çertifikata nga Gjykata që nuk jeni nën hetim.

Data e mbajtjes së testit me shkrim dhe intervistës, për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara sipas këtij konkursi, do të publikohen vetëm në faqet zyrtare të: Prokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo/ Republic of Kosovo**  
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council  
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat

Na osnovu člana 10 i 11 u vezi sa članom 14A Zakona Br. 05/L-035 za Izmene i Dopune Zakona Br. 03/L-224 za Tužilački Savet Kosova, na osnovu Zakona Br.03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova i Pravilnika Br. 02/2010 za Procedure Rekrutovanja u Civilnoj Službi Kosova, Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova objavljuje:

**KONKURS**

**1. Viši Referent Osnovno Tužilaštvo u Gnjilane jedna (1) pozicija**

REFERENCA	Kodi: SKPK/PTH/ POZ - 009
Naziv Pozicije:	<b>Viši Referent</b>
Pozicija:	Pozicija od karijere
Nivo:	Profesionalni 2
Radni Kod:	DR/ 850 DU+2
Raportira kod:	Administrator
Radni Stepen:	9
Broj Pozicija:	Jedna(1) pozicija
Koeficijent:	Sedam (7)
Akt imenovanja :	Bezročno
Probni rad:	Dvanacst (12) meseci
Mesto:	Gnjilane

**Cilj radnog mesta:**

Pružna širu administrativnu i tehničku podršku u vezi primljenih predmeta u organizativnoj jedinici gde je zapošljen/a, vodi tačne i blagovreme evidencije u registru za upisanje predmeta i registru za otpisanje predmeta na osnovu specifikovanih zahteva samog registra, vođenje računa o predmetima i spisa predmeta.

**Glavne Obaveze i Odgovornosti:**

Blagovremeno registruje predmete u registru za prijem predmeta sa svim podacima koji se traže na osnovu registra vodeći tačne evidencije predmeta i spisa predmeta uz uvođenje elektronske evidencije;

Otpisuje predmete i vodi tačne evidencije predmeta u odgovarajućem registru i elektronskim putem, vodi evidencije o specifičnim predmetima i onih od posebne značajnosti, postupajući samo-inicijativno i bez direktnog nadzora;

Odgovoran za rokove i radne preciznosti;

Nadgleda sistem praćenja predmeta i upravlja sa predmetima na osnovu radnog opterećenja;

Kontroliš predmeta i njihovo kretanje unutar institucije, uz spremnost da u svakom trenutku obezbedi predmet za zastupanje u Sudu;

Vodi tačne i potpune evidencije u vezi dosijea i spisa predmeta, akata, ostalih službenih spisa i dokumenata, uključujući i pripremanje izveštaja o obavljenom radu u određenim izveštajnim periodima;

Spreman za obavljanje svake druge obaveze kao referentat u pisarnici u skladu sa važećim zakonima i propisima;

Obavlja i ostale poslove u vezi sa radom referentata koje se mogu povremeno razumno zahtevati.

**Znanje, veštine, sposobnosti za radno mesto:**

Dobre pismene i usmene komunikativne veštine,

Sposobnosti za uređivanje i pažljivog sačuvanja dosijea i spisa predmeta,

Sposobnost da radi samostalno i u timskom radu,

Dobre sposobnosti rada kompjuterom (Word i Excel).

**Stručna sprema i kvalifikacija:**

Univerzitetska Diploma, Društvene Nauke, Javna Uprava.

**Radno Iskustvo:**

Najmanje 2 godine radnog iskustva.

Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja na službenoj stranici Državnog Tužioca i Tužilačkog Saveta Kosova, kao i u dnevne novine, počevši od 23.11.2018 do 07.12.2018 kao datum isteka konkursa.

**Podnošenje prijave:** Formular za apliciranje može se podići na recepciji zgrade Državnog Tužioca adresa Ulica: "Luan Haradinaj" b.b. ili se može skinuti sa web stranice <http://www.kpk-rks.org/> ili <http://www.psh-ks.net/>.

**Aplikacije se predaju svakog radnog dana od 08:00 do 16:00, u Diviziji Ljudskih Resursa, VII sprat, Kancelarija br. 702, Priština, Kosovo.**

Aplikacije poslate putem pošte, koje sadrže poštanski pečat nad pošiljkom sa datumom poslednjeg dana roka za apliciranje, smatraće se važećim i uzeće se na razmatranje, ako stižu u roku od 4 dana, aplikacije koje stižu posle ovog roka ili su nekompletirane neće se uzeti u obzir uopšte.

U slučaju potrebe možete da nas kontaktirate na, tel: 038 / 200 18874 od 08:00 do 16:00 časova.

**Uslovi učešća na konkursu:**

Pravo apliciranja imaju svi građani Republike Kosova odrasle dobi koji imaju punu sposobnost delovanja, poseduju civilna i politička prava, imaju potrebnu školsku spremu i stručne sposobnosti za vršenje dužnosti kao i fizičkih sposobnosti koja se traže za dotičnu poziciju.

Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim državljanima Kosova i dočekuje aplikacije od sviju osoba muškog i ženskog pola iz redova svih zajednica na Kosovu.

"Nevećinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravedno i proporcionalno zastupanje u organima civilne službe centralne i lokalne državne administracije kao što je specifikovano članom 11, stav 3 Zakona br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova."

Aplikacijama se moraju sastaviti kopije zatražene dokumentacije:

- 1.Svedočanstvo školske spreme;
- 2.Dokaz o radnom iskustvu; *Potvrda ili radni ugovor.*
- 3.Dve preporuke (ako imate);
- 4.Kopije dva poslednja naizmenična izveštaja procene rada (ako takvi postoje);
- 5.Dokument identifikacije-fotokopirana lična karta;
- 6.Uverenje od Suda da niste pod istragom.

Datum održavanja pismenog testa i intervjuja, za kandidate koji ispunjavaju uslove predviđene po ovom konkursu, objaviće se samo na službenim web-stranicama Državnog Tužioca i Tužilačkog Saveta Kosova.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



### DOLI NË SHITJE LIBRI EKSKLUZIV I AUTORIT FATON MEHMETAJ, "VEPRIMTARIA E SHËRBIMEVE SEKRETE RUSE NË SHTETET E BALLKANIT"

Libri më i ri i studiuesit dhe njohësit të mirë të çështjeve të sigurisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, Faton Mehmetaj, "Veprimtaria e shërbimeve sekrete ruse në shtetet e Ballkanit", sjellë të dhëna dhe dëshmi tronditëse mbi shtrirjen dhe

- veprimtarinë e shërbimeve sekrete ruse në Ballkan.
- Si tentuan shërbimet ruse ta destabilizojnë Kosovën?
- Si tentuan grusht shtetin në Mal të Zi, në Shqipëri e Maqedoni?
- Cilat janë shërbimet ruse që operojnë në Ballkan?
- Cilat janë format dhe metodat e shërbimeve sekrete ruse për të destabilizuar rajonin?
- Cila është strategjia e tyre operuese?
- Si ndikuan këto shërbime nëpërmjet medieve, politikës, ekonomisë, të fuqizojnë politikanë dhe struktura politike për t'i pozicionuar në strukturat më të larta të shteteve të rajonit për të mbrojtur interesat pro-ruse?


Përgjigjet në këto pyetje dhe në shumë e shumë pyetje të tjera i gjeni në librin ekskluziv "VEPRIMTARIA E SHËRBIMEVE SEKRETE RUSE NË SHTETET E BALLKANIT", një studim hulumtues, i autorit Faton Mehmetaj, i pari i këtij lloji dhe njëherësh ndër librat më të kërkuar nga lexuesit, ku nxirret lakuriq veprimtaria destabilizuese e shërbimeve ruse në rajon.

Libri përmban 214 faqe dhe është botim i përbashkët i Institutit për Studime Gjeopolitike dhe Siguri (ISGJS) dhe Gazetës së Përditshme Shqiptare "EPOKA E RE", në Prishtinë.



**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



## OFERTË PËR SHITJE TË SHTËPISË

Shitet shtëpia dykatëshe, me sipërfaqe prej 218 m<sup>2</sup>, dhe trualli me sipërfaqe prej 410 m<sup>2</sup>.

Shtëpia gjendet në Prishtinë, në lagjen "Aktash I", rr. "Ferhat Draga" nr. 1.

Procedura e transaksionit nga shitësi te blerësi bëhet pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes dhe pagesës së çmimit të kontraktuar, pastaj paluejtshmëria e përshkruar më lart kalon te blerësi.

Çmimi sipas marrëveshjes.

**Informata më të hollësishme mund të merren në numrin e telefonit 001-347-331-8305 në Nju Jork, kurse në Prishtinë në celularin 044-166-580.**

### Thirrje për aplikim

Preveza Isuf Kelmendi përfituese kërkojmë ofertues /kontraktorë, kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojnë një ofertë propozim për mallrat punët shërbime këshilluese si në vijim: (Ofroni një përshkrim të shkurtër, ndërtim i serrës 5000 m<sup>2</sup> pesë mijë metra katror me material të zinguar).

Kompania e interesuar duhet të kontaktojë direkt tek Preveza Kelmendi nëpërmjet emailit apo telefonit, për të kërkuar një ftesë për kuotim tek adresa e caktuar si më poshtë.

(lejoni 5 dit nga data e publikimit).

Emri i përfituesit Preveza Kelmendi

Adresa sheshi "Adem Jashari" Lipjan, telefoni: 044-315-716

Email:

Oferta/ propozimet duhet të dozohen tek adresa e përfituesit me 27.11.2018. dhjet ditë pasi që ftesa për kuotim të jetë dërguar tek të gjithë ofertuesit-kompanitë e interesuara.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Faton Ninaj shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren

► Kreshnik Qovanaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren

► Jeta Kiseri shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMGJ "Gjon Buzuku" Prizren

► Dem Belaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHFMU "Bajram Curri" Romajë.

► Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gobjule Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuari i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një çift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m<sup>2</sup>. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

## NPT AGROKOVRAKA-FRUT

### SHPALL TENDER PER NDERTIMIN E DEPOS

1. PLLAKA DHE IZOLIMET E PLLAKES
2. KONSTRUKSIONI I QELIKUT ME PANEL FRIGO

NUMRI KONTAKTUS 044140588 Kovragë -Istog  
n-azi.b@hotmail.com



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës  
Ministarstvo za Kosovske Bezbednosne Snage - Ministry for the Kosovo Security Force



## **DITA E FORCËS – DITË E HAPUR**

*Forca e Sigurisë së Kosovës, më datë 27 nëntor 2018,  
nga ora 10:00 deri në ora 13:00, organizon  
Ditën e Hapur për nder të Ditës së Forcës.*

**FSK mirëpret qytetarët në të gjitha kazermat e FSK-së, si në  
Prishtinë, Mitrovicë, Istog, Gjilan, Prizren, Ferizaj dhe Pomozotin.**

**Vizitorët do të kenë mundësi të shohin pajisje, demonstrime si dhe  
aktivitete të ndryshme të cilat dëshmojnë kapacitetet e FSK-së.**

**Të nderuar qytetarë, ejani të festojmë  
së bashku "DITËN E FORCËS"!**



**Prishtinë, nëntor 2018**